



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

KONFIRMIM DEPOZITIMI DOKUMENTACIONI NË GJYKATË KUSHTETUESE

Në datë 03.07.2026, ora 15:05 u depozitua në Gjykatën Kushtetuese dokumentacioni me dërgues 1/4 e Deputetëve Av. Marash Logu dhe objekt:/lëndë: zgjodhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet 1/4 Deput. dhe Kuvendit të R. Sh. mbi ngritjen e Komisionit Hetimor të

Përgjegjëse e protokoll-arkivit në Gjykatën Kushtetuese

Alketa Spahiu

Nënshkrimi (vula e sekretarisë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

Tiranë, më 03/072026

## K Ë R K E S Ë

**DREJTUAR:** GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**KËRKUES:** JO MË PAK SE 1/4 E DEPUTETËVE TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga Kryetari i Grupit Parlamentar të PD z. Gazment Bardhi, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, Kryetari i Grupit Parlamentar të PL z. Tedi Blushi, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, si dhe avokat Marash Logu, me adresë: “Kryesia e Kuvendit, Grupi Parlamentar i PD, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë”; dhe email [marashlogual@gmail.com](mailto:marashlogual@gmail.com).

**SUBEJKTE TË INTERESUARA:** KUVENDI I SHQIPËRISË, me adresë Kryesia e Kuvendit, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë

**OBJEKT:**

- Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit:
  - “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”;
  - “Për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend i NATO-s”.
- Deklarimi i vendimit nr. 57/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Deklarimi i vendimit nr. 58/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend i NATO-s”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 7, 77, 78, dhe 131, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*);  
Neni 25 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;  
Nenet 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*);  
Ligji nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar (*ligji nr. 8891/2002*).

*E nderuar znj. Kryetare e Gjykatës Kushtetuese,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë të Gjykatës Kushtetuese*

Ne, jo më pak se 1/4 e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, pasi përmes vendimeve të Kuvendit të Shqipërisë nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026, na është mohuar kompetenca dhe e drejta kushtetuese e parashikuar nga neni 77 i Kushtetutës, paraqesim përpara Gjykatës Kushtetuese këtë kërkesë, bazuar në faktet, rrethanat dhe provat<sup>1</sup> e mëposhtme:

## I. RRETHANAT E FAKTIT

1. 39 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që përbëjnë jo më pak se 1/4 të deputetëve të Kuvendit, kanë paraqitur kërkesën nr. 1404, datë 01.04.2026 për krijimin e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”.

2. Hetimi parlamentar i kërkuar lidhet me faktin se gjatë muajve të fundit, në mënyrë të veçantë gjatë muajit Shkurt 2026, Shqipëria ka përjetuar dëmtime të jashtëzakonshme të infrastrukturës rrugore të vendit, përfshirë dëmtime serioze të urave dhe veprave të tjera civile, që arritën kulmin në rrëshqitjet e trasesë së rrugës në aksin Jug-Lindor, me pasoja bllokimin e tij të plotë. Gjatë periudhës 2014-2025 janë investuar në infrastrukturën rrugore rreth 4 miliard euro, një vlerë shumë e lartë e investimeve publike. Këto vlera të larta të përdorimit të parave të taksapaguesve janë një detyrim i rëndësishëm për tu mirembajtur dhe për të gjetur e analizuar gjithë faktorët e amortizimit

<sup>1</sup> Lista e provave bashkëlidhur:

1. Kërkesa nr. 1404, datë 01.04.2026 për krijimin e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”.
2. Kërkesa nr. 1440 Prot, datë 3.4.2026, për krijimin e komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSH), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s”.
3. Urdhër nr. 22, datë 3.4.2026 i Kryetarit të Kuvendit për thirrjen e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve në datën 7.4.2026.
4. Procesverbal i mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, datë 7.4.2026, ora 11:30.
5. Urdhër nr. 23, datë 7.4.2026 i Kryetarit të Kuvendit për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit në seancë plenare në datën 9.4.2026, ora 10:00.
6. Procesverbal i seancës plenare të datës 9.4.2026.
7. Vendim nr. 57/2026 i Kuvendit për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”.
8. Vendim nr. 58/2026 i Kuvendit për mosmiratimin e projektvendimit “Për krijimin e komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSH), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s”.

të shpejtë të tyre, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe rentabilitetit të investimeve sot dhe në të ardhmen.

3. Kërkesa e argumentuar ku paraqiten edhe faktet dhe grupfaktet që përbëjnë shkakun e këtij hetimi parlamentar, ka përcaktuar qartë objektin dhe detyrimin e Komisionit për të respektuar parimet kushtetuese. Kështu, kërkesa dhe projektvendimi shoqërues, përcaktojnë qartë se: *“II. Objekt i punës së Komisionit do të jetë: a) verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar; b) verifikimi dhe testimi i respektimit të standardeve të ndërtimit nga kompanitë ekzekutuese të punimeve. c) verifikimi dhe vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve, enteve e shoqatave të profesionistëve, në funksion të garantimit të standardeve të larta në projektimin dhe zbatimin e veprave publike. d) hartimi i rekomandimeve për të përmirësuar punën në të ardhmen. III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese dhe ligjet e vendit.”*

4. Gjithashtu, 40 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë që përbëjnë jo më pak se 1/4 e deputetëve të Kuvendit, kanë paraqitur kërkesën nr. 1440 Prot, datë 3.4.2026, për krijimin e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSH), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s”.

5. Hetimi parlamentar i kërkuar lidhet me faktin se Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) administron infrastrukturën digjitale kritike të Republikës së Shqipërisë. Nëpërmjet platformës e-Albania, AKSHI menaxhon të dhënat identifikuese, certifikatat e lindjes, të dhënat tatimore, regjistrin civil dhe pronat e të gjithë qytetarëve shqiptarë. Si institucion i vënë drejtpërdrejt nën autoritetin Kryeministrit, AKSHI përfaqëson nyjen qendrore të sovranitetit digjital të shtetit, funksionimi korrekt i të cilit është i lidhur drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare dhe detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s. Gjatë kësaj periudhe, ka pasur një sërë rrjedhjesh të mëdha të të dhënave të cilat kanë prekur qindra mijëra qytetarë shqiptarë:

- a) Prill 2021: 910,000 qytetarë të Tiranës panë se të dhënat elektorale, preferencat politike dhe informacione konfidenciale, përfshirë numrat e identifikimit personal, rrodhën në prag të zgjedhjeve, dhe ishin të aksesuara nga Partia Socialiste, nëpërmjet asaj që mediatikisht u quajt skema e patronazhimit.
- b) Dhjetor 2021: 637,138 qytetarë panë se si u bënë publike pagat, ID-të dhe të dhënat e punësimit, në një dokument Microsoft Excel, të qarkulluar në programin e komunikimit WhatsApp.
- c) Tetor 2022: MEMEX, sistemi kriminal i Policisë së Shtetit, u hakerrua, duke ekspozuar 105,000 skedarë hetimesh.
- ç) Në nëntor 2022: 600 oficerë të inteligjencës shqiptare të ekspozuar me emra, e-maile dhe numra telefoni.
- d) Në mars 2026: Sipas raportimeve mediatike që i referohen burimeve të FBI-së, të dhënat e shqiptarëve janë në shitje, ku ato të e-Albania mund të kushtojnë 0.05 BTC (bitkoin, rreth 3,000 €), ndërsa databaza e kartave ID të shqiptarëve kushton 0.01 BTC (bitkoin, rreth 600 Euro).

6. Kërkesa e argumentuar ku paraqiten edhe faktet dhe grupfaktet që përbëjnë shkakun e këtij hetimi parlamentar, ka përcaktuar qartë objektin dhe detyrimin e Komisionit për të respektuar parimet kushtetuese. Kështu, kërkesa dhe projektvendimi shoqërues, përcaktojnë qartë se: “II. Komisioni Hetimor ka për objekt të veprimtarisë së tij: i) Verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit që lidhen me bazat e të dhënave shtetërore, për periudhën 1 Janar 2014 – 31 Mars 2026; ii) Verifikimin nëse operatorë ekonomikë të kontraktuar kanë pasur akses në sistemet kritike digjitale dhe në çfarë kushtesh, përfshirë nëse është respektuar vetingu i sigurisë; iii) Analizimin e ndikimit të rrjedhjeve të të dhënave të viteve 2021–2022 në të drejtat e qytetarëve dhe në sigurinë kombëtare, si dhe vlerësimin e përgjegjësisë institucionale për këto incidente; iv) Nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale për emërimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e drejtuesve të AKSHI-t gjatë kësaj periudhe; v) Vlerësimin e respektimit të standardeve të NATO-s për mbrojtjen e infrastrukturës kritike digjitale dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë; vi) Propozimin e masave ligjore dhe institucionale të nevojshme për të garantuar në të ardhmen funksionimin e sigurt dhe transparent të infrastrukturës digjitale shtetërore. III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve, prezumimit të pafajësisë, paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.”.

7. Në bazë të urdhrin nr. 22, datë 3.4.2026, në mbështetje të nenit 7, pika 6; nenit 12, pika 2; nenit 25 dhe nenit 98 të Rregullores së Kuvendit, si dhe ligjit nr. 8891/2002, Kryetari i Kuvendit thirri mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve në datën 7.4.2026, me rend dite: “1. Shqyrtimi i projektkalendarit të punimeve të Kuvendit për periudhën 13 prill – 30 prill 2026. 2. Shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga 39 deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë së Lirisë dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike “Për krijimin e komisionit hetimor të Kuvendit, “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”. 3. Shqyrtimi i kërkesës së paraqitur nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike “Për krijimin e komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s ”.”.

8. Në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të zhvilluar më datë 7.4.2026, mazhoranca refuzoi ngritjen e të dy Komisioneve Hetimore. Ajo parashtoi këtë qëndrim:

(i) Mbi kërkesën nr. 1404, datë 01.04.2026:

*Për sa i përket kërkesës së 39 deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, anëtarë të grupeve parlamentare të Partisë së Lirisë dhe Partisë Demokratike, lidhur me ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor, për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”, nga ana e kërkuësve vendosen si bazë ligjore nenet 7, 77 dhe 78 të Kushtetutës, neni 25 i Rregullores dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore në Kuvendin e Shqipërisë”.*

*I nderuar, zoti Kryetar,*

*Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,*

*Kërkesa të kësaj natyre, për ngritjen e komisioneve hetimore, përveç kësaj baze ligjore që sipërcitova, duhen parë dhe në prizmin dhe këndvështrim të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë pasuruar kuadrin kushtetues dhe ligjor të shqyrtimit të tyre, të cilat duhen parë në 5 parime themelore. Jam tërësisht dakord me faktin që kërkesa për ngritjen e një komisioni hetimor është një e drejtë e pakicës parlamentare dhe, në këtë këndvështrim, kjo e drejtë e kësaj pakice nuk është e pakufizuar. Është e vërtetë që Gjykata Kushtetuese ka thënë se komisionet hetimore janë instrument kontrolli i Kuvendit dhe veçanërisht - citon Gjykata*

*Kushtetuese në disa vendime të veta - i pakicës parlamentare. Në aspektin e këtij parimi, kërkesa i plotëson kushtet ligjore, pra, numrin e firmave, ndërkohë që detyrimi i Kuvendit, parimi i detyrimit mbi të cilin dua ta ndërtoj argumentim tim, është ta shikojë këtë kërkesë jo vetëm në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin, por edhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese, e cila, në këndvështrimin tim, ose në parimin tim të tretë, ka përcaktuar edhe kufizimet kushtetuese të hetimit. Gjykata ka vendosur se komisionet e kërkuara hetimore nuk mund të hetojnë çështje që janë në shqyrtim nga gjykatat, po ashtu nuk mund të cenojnë të drejtat themelore të individëve dhe nuk mund të ushtrojnë funksione gjyqësore. Parimi i katërt është qëllimi i këtyre komisioneve, që duhet të jetë mbledhja e fakteve dhe kontrolli politik, jo dhënia e vendimeve penale apo civile, që nuk është në kompetencën e tyre.*

*Parimi i pestë, tek i cili dua të ndalem me këtë kërkesë, është parimi themelor i proporcionalitetit. Gjykata Kushtetuese në disa raste, dhe nuk është rasti t'i citoj të gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese, e thotë shumë qartazi: objekti i hetimit duhet të jetë i qartë dhe i kufizuar. Nuk mund të ketë fishing expedition, pra të ketë një proces pa objekt konkret, por domosdoshmërisht duhet të vish me një objekt konkret. Zonja dhe zotërinj deputetë, anëtarë të Konferencës së Kryetarëve, në vlerësimin tonë kërkesa "Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore", në tërësinë e saj, e cila ka më shumë faqe me firma sesa thelbin e kërkesës, ku bëhet fjalë që gjatë periudhës 2014-2025 të hetohen të gjitha procedurat e ndjekura nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, nuk ka paraqitur asnjë çështje me objekt konkret, por është thjesht dhe vetëm një kërkesë, e cila mund të ezaurohej ndoshta me një interpelancë apo me një instrument tjetër të kontrollit parlamentar, pa qenë e nevojshme për të shkuar në një komision hetimor parlamentar. Kjo për shkak se në kërkesë, sipas këndvështrimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk ka një rast konkret për një çështje konkrete, e cila ta përfshijë Kuvendin, edhe për natyrën që ka Kuvendi, jo të zëvendësojë prokurorin dhe gjykatën, por t'i shikojë ato në këndvështrimin politik për sa i përket hartimit të legjislacionit, përmirësimit të legjislacionit e të tjera me radhë. Kështu që, zoti Kryetar, bazuar në normën që parashikon ligji i posaçëm për komisionet hetimore, ne nuk shprehim dakordësinë tonë për ngritjen e këtij komisioni dhe, për pasojë, çuarjen e tij për vendimmarrje në seancë plenare."<sup>2</sup>*

(ii) Mbi kërkesën nr. 1440, datë 03.04.2026:

*"Zoti Kryetar i Kuvendit, do të flas shkurt, sepse pak a shumë diskutimi që parapriu diskutimin për këtë çështje në kërkesën pararendëse ishte shterues, në këndvështrimin tonë, sa i përket kuadrin kushtetues ligjor që duhet të përmbushë një kërkesë për një komision hetimor. Shqyrtimi, që e ka për detyrë Kuvendi, duhet bërë pikërisht mbi kufizimet kushtetuese të hetimit. Është e qartë se Kuvendi nuk mund të hetojë çështje që janë në shqyrtim nga pushteti tjetër, ai gjyqësor, bazuar ky në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në parimin e përgjithshëm të ndarjes së pushteteve. Ne nuk mund të ushtrojmë funksione gjyqësore, siç thotë Gjykata Kushtetuese në vendimet që citova më sipër, e cila, në mënyrë të vazhdueshme, e ka forcuar këtë parim. Edhe pse e drejta e pakicës parlamentare në parim duket e pakufizuar, duhet ta përmbushim këtë detyrim, sikurse edhe parimin e proporcionalitetit. Pra, nuk jemi përpara një kërkesë që ka një objekt të qartë, të kufizuar për një çështje të veçantë, por kemi një parashtrim evaziv të një kërkesë, e cila është në hetim nga drejtësia, dhe drejtësia ka të gjithë mbështetjen për ta kryer këtë proces të plotë. Në këtë këndvështrim, ftoj Konferencën e Kryetarëve ta rrëzojë këtë kërkesë."<sup>3</sup>*

9. Sikurse rezulton nga qëndrimi i mësipërm, mazhoranca parlamentare, përmes Kryetarit të Grupit, ka mbajtur një argumentim të përgjithshëm dhe jo konkret mbi refuzimin e kërkesave për Komision Hetimor. Pavarësisht qasjes së pakicës parlamentare për bashkëpunim, mazhoranca parlamentare nuk ka bërë asnjë përpjekje në drejtim të respektimit të të drejtës së pakicës për hetim parlamentar, duke cenuar në këtë mënyrë parimin kushtetues të bashkëpunimit dhe respektit të ndërsjellë.

<sup>2</sup> Shiko faqet 17-18 e vijues të Procesverbalit të mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve të datës 07.04.2026 mbi debatin mbi këtë kërkesë.

<sup>3</sup> Shiko faqen 31 e vijues të Procesverbalit të mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve të datës 07.04.2026 mbi debatin mbi këtë kërkesë.

10. Në këtë mënyrë, “argumentet” e paraqitura janë thjesht një alibi për të mohuar të drejtat kushtetuese të pakicës parlamentare, dhe mazhoranca me forcën e kartonit në seancën plenare të datës 09.04.2026, rrëzoi të drejtën e opozitës për ngritjen e dy Komisioneve Hetimore, përmes miratimit të vendimeve të Kuvendit nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026, pa argumentuar arsyet në pikëpmje të respektimit të Kushtetutës dhe pa ofruar asnjë formulim alternativ.

11. Për këtë arsye, është krijuar një konflikt kompetencash mes pakicës prlamentare (nënkupto 1/4 e deputetëve kërkues) dhe Kuvendit të Shqipërisë (nënkupto shumicën parlamentare) që duhet të zgjidhet nga Gjykata Kushtetuese, duke vendosur:

- Detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit: “Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”; dhe “Për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend i NATO-s”.
- Deklarimi i vendimit nr. 57/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- Deklarimi i vendimit nr. 58/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend i NATO-s”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

12. Kjo për faktin se, sipas nenit 77 të Kushtetutës dhe vendimeve të shumta të Gjykatës Kushtetuese:

- Komisionet hetimore janë mjet efektiv kontrolli që veprojnë vetëm brenda hapësirës kontrolluese të parlamentit, të cilat ngrihen për çështje të veçanta, të lidhura në mënyrë funksionale me pushtetin e ligjvënësit. **Ngritja e komisioneve hetimore parlamentare, kur kërkohet nga një e katërta e deputetëve, është e detyrueshme.**
- Në një regjim parlamentar nuk është shumica ajo që vëzhgon qeverisjen, por kjo konsiderohet tashmë si detyrë e opozitës. Prandaj kjo e drejtë e pakicës për të ngritur komisione hetimore, e garantuar me Kushtetutë, **duhet të mbetet gjithmonë e paprekur**<sup>4</sup>.
- Është e vërtetë që Gjykata Kushtetuese ka pohuar se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. **Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese**<sup>5</sup>. Gjykata Kushtetuese ka identifikuar një kusht gjatë procesit parlamentar, sipas të cilit **shumica parlamentare, në rastet kur pretendon se çënohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit, është e detyruar të propozojë formulime alternative**, duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj<sup>6</sup>.

<sup>4</sup> Shih vendimin nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>5</sup> Shih vendimin nr. 57, datë 23.07.2015 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>6</sup> Shih vendimin nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese

13. Ne deputetët e pakicës parlamentare jemi të vendosur për të qëndruar të angazhuar në proceset demokratike brenda sistemit institucional, por nuk do të pajtohemi kurrë me asgjësimin e parlamentarizimit apo mohimin e të drejtave tona kushtetuese. Një vend që pretendon antarësimin në Bashkimin Europian, që cenon rregullat minimale të bashkëjetesës demokratike brenda Kuvendit, ku mazhoranca ka rolin e saj dhe opozita përgjegjësitë e saj, nuk mund të jetë asgjë më shumë se një propagandë e papërgjegjshme për një normalitet të rremë demokratik. Këtë realitet të rremë mund dhe duhet ta korrigjojë sistemi i garancive kushtetuese institucionale – ku rolin kyc e ka Gjykata Kushtetuese.

14. Mazhoranca parlamentare ditë pas dite po e trajton Kuvendin si njëpartiak, dhe ku cdo vendimmarrje diktohet jo nga forca e arsyes/argumentit, por nga forca e kartonave të tyre. Ajo vazhdon të mohojë ushtrimin e cdo të drejte parlamentare të deputetëve të opozitës, duke i penguar ata në ushtrimin e përgjegjësisë të tyre në mbrojtje të interesit publik. Deri më tani nuk është pranuar asnjë kërkesë e pakicës parlamentare për ngritjen e Komisioneve Hetimore<sup>7</sup>.

15. Rrëzimi me votë politike të mazhorancës i një të drejte kushtetuese të opozitës, e bën rolin e deputetëve të saj në Kuvend, jo thjesht të papërfillshëm, por mbi të gjitha fasadë e një normaliteti të rremë që vret cdo ditë rregullat dhe standardet minimale të parlamentarizimit demokratik. Nëse opozita nuk diskuton dot në Kuvend çështje që kanë interes për qytetarët, nëse nuk ushtron dot kontroll ndaj qeverisjes, nëse nuk shtyn dot përpara miratimin e ligjeve/amendamenteve në interes të qytetarëve, nëse nuk përfillet në të drejtat e saj që ia njeh Kushtetuta e Shqipërisë, atëherë roli i saj në Kuvend është thjeshtë formal duke mos përmbushur përgjegjësitë e veta në një shoqëri demokratike dhe duke dëmtuar kështu sistemin e kontrollit dhe balancës mes pushteteve, si garanci për funksionimin demokratik të shtetit shqiptar.

## II. BAZA LIGJORE

### A. Kushtetuta

16. Neni 7: *“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.”*

17. Neni 77: *“1. Kuvendi zgjedh nga gjiri i tij komisione të përhershme, si dhe mund të caktojë komisione të posaçme. 2. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një së katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t’i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore. 3. Komisionet e hetimit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.”*

18. Neni 131, pika 1, shkronja “ç”: *“Gjykata Kushtetuese vendos për: “ç) mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore;”*

<sup>7</sup> Refuzimi i përsëritur i kërkesave të opozitës për ngritjen e komisioneve hetimore coi në një krizë parlamentare të thellë në legjislatoren e kaluar gjatë periudhës Tetor 2023 - Mars 2024. E njëjta sjellje recidive dëshmon që kemi të bëjmë me një strategji të shtrirë në kohë nga mazhoranca për kufizimin e të drejtave të opozitës deri në asgjësimin e tyre të plotë.

## **B. Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë**

19. Neni 25: “1. Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesën e një të katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë një komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. 2. Komisionet hetimore të Kuvendit veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.”.

## **C. Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar**

20. Neni 54: “1. Në mbështetje të nenit 131 shkronja “ç” të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese shqyrton konfliktet e kompetencës ndërmjet pushteteve, si dhe ndërmjet pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore dhe kur mosmarrëveshja ka lidhje të drejtpërdrejtë me ushtrimin e veprimtarisë së tyre. 2. Gjykata Kushtetuese merr në shqyrtim këto konflikte kur subjektet përkatëse e kanë konsideruar veten kompetente për të vendosur për çështje konkrete dhe sipas rastit kanë nxjerrë aktet për rregullimin e saj ose kur subjektet nuk e kanë konsideruar veten kompetente të vendosin në raste të veçanta. 3. Kërkesa para Gjykatës Kushtetuese ngrihet nga subjektet në konflikt ose nga subjektet e cenuara drejtpërdrejt nga konflikti. 4. Çdo lloj akti me karakter ligjor e nënligjor, veprim ose mosveprim i organeve të pushteteve ose i organeve të qeverisjes vendore, që kanë çuar në mosmarrëveshje kompetencash midis tyre, përbëjnë bazat për fillimin e shqyrtimit të këtyre çështjeve.”.

21. Neni 55: “Kërkesa për shqyrtimin e këtyre mosmarrëveshjeve paraqitet brenda 6 muajve nga çasti i lindjes së konfliktit.”.

22. Neni 56: “1. Gjykata Kushtetuese vendos se cili organ i pushtetit ka në kompetencë të tij zgjidhjen e çështjes konkrete, për të cilën ka lindur mosmarrëveshja. 2. Kur zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës është e lidhur me akte ligjore ose nënligjore të nxjerra nga organet palë në konflikt, Gjykata Kushtetuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes shqyrton edhe kushtetutshmërinë apo ligjshmërinë e aktit.”.

## **D. Ligji nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar (ligji nr. 8891/2002).**

23. Neni 5: “1. Komisioni krijohet me kërkesë të 35 deputetëve. Grupi nismëtar paraqet qëllimin e krijimit të komisionit, çështjen që do të hetohet, propozimin për përbërjen e komisionit dhe afatin e përafërt të përfundimit të hetimeve. Kuvendi është i detyruar të miratojë ngritjen e komisionit kur objekti i hetimit respekton parimet dhe standardet kushtetuese si më poshtë: a) çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera të Kuvendit; b) objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; c) duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme për ekzistencën e çështjes për të cilën kërkohet ngritja e komisionit hetimor.”.

24. Neni 8: “1. Kuvendi miraton ngritjen dhe përbërjen e komisionit të kërkuar, sipas nenit 5 të këtij ligji, me shumicën e thjeshtë të deputetëve të pranishëm. 2. Vendimi i Kuvendit duhet të përmbajë qëllimin e krijimit të komisionit, objektin e hetimit, numrin dhe anëtarët e tij, sipas përkatësisë politike, si dhe kryetarin e zëvendëskryetarin. 3. Kuvendi nuk mund të vendosë kufizime në objektin e punës, përbërjen dhe kohëzgjatjen e komisionit të kërkuar nga grupi i deputetëve nismëtarë, përveç rasteve kur nga rrethanat gjykohet se kërkesa përmban elemente të shkeljes së Kushtetutës.”.

### III. MBI THEMELIN E KËRKESËS

#### III/1. Për legjitimimin e kërkesit

25. Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj është shprehur për legjitimimin e një grupi deputetësh në kërkesat për zgjidhjet e mosmarrëveshjeve së kompetencave që kanë lindur për shkak të vendimmarrjeve të Kuvendit mbi Komisionet Hetimore<sup>8</sup>. Në këtë drejtim ajo ka çmuar se çdo organ juridiksional, qoftë institucion ose organ pushteti, në kuptimin klasik administrativ të tij, apo edhe subjekt që ushtron funksionet në një situatë pavarësie të plotë të garantuar nga Kushtetuta, konsiderohet i legjitimuar për të qenë palë në mosmarrëveshje pushtetesh.

26. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se neni 77, pika 2, i Kushtetutës i njej pakicës parlamentare kompetencë hetimi, pengimi i së cilës përbën konflikt kushtetues kompetencash. Vendimi i Kuvendit për mosmiratimin e kërkesës së një të katërtës së deputetëve për ngritjen e Komisionit Hetimor parlamentar cenon këtë të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare. Situata të tilla, në vlerësimin e Gjykatës Kushtetuese, shkaktojnë në realitet një mosmarrëveshje ndërmjet pakicës parlamentare (jo më pak se një e katërta e deputetëve), nga njëra anë, dhe Kuvendit, nga ana tjetër, për ushtrimin e së njëjtës kompetencë kushtetuese<sup>9</sup>.

27. Përsa i përket legjitimitit formal të kërkesit<sup>10</sup>, rezulton se kërkesat për ngritjen e Komisioneve Hetimore janë nënshkruar nga 39-40 deputetë, të cilët janë të njëjtët me kërkesit që kanë nënshkruar kërkesën përpara Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, kërkesi legjitimohet *ratione personae* për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese.

28. Nga ana tjetër, për sa i takon legjitimitit *ratione temporis* kërkesa për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeve është paraqitur brenda 6 muajve nga çasti i lindjes së konfliktit (data 09 Prill 2026). Në këtë rast, kërkesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, sepse ka ngritur pretendimet e tij mbi një të drejtë kushtetuese që i është mohuar në kundërshtim me Kushtetutën nga Kuvendi i Shqipërisë, duke krijuar konflikt kompetencash dhe duke sjell si pasojë miratimin e dy vendimeve nga ana e Kuvendit të Shqipërisë që janë të papajtueshme me Kushtetutën.

29. Për arsyet e mësipërme, kërkesi, jo më pak se një e katërta e deputetëve (46 deputetë), legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet subjekteve kushtetuese të sipërcituara, si dhe kërkesën e tij, që si pasojë, vendimet nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026 të Kuvendit të Shqipërisë, të deklarohen si të papajtueshëm me Kushtetutën.

#### III/2. Lidhur me të drejtën e pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një Komisioni Hetimor

30. Përpara argumenteve mbi papajtueshmërinë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026 të Kuvendit, me qëllim qartësimin e raportit midis pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor dhe të drejtës së Kuvendit për krijimin e tyre, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ne kërkesit vlerësojmë të arsyeshme të

<sup>8</sup> Shih vendimet nr.18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr.30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>9</sup> Shih vendimet nr.18, datë 14.05.2003; nr. 20, datë 04.05.2007; nr.30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>10</sup> Shih vendimin nr. 9, datë 28.03.2022 të Gjykatës Kushtetuese

ndalemi fillimisht në kompetencën e një të katërtës së të gjithë deputetëve për të iniciuar një hetim parlamentar.

31. Sipas nenit 77, pika 2 të Kushtetutës, Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një të katërtës të të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Në interpretimin e këtij formulimi kushtetues, në disa vendime të saj<sup>11</sup>, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se Kuvendi vihet në dy pozicione të ndryshme. Në njërin rast, krijimi i komisionit hetimor paraqitet si një e drejtë e Kuvendit, gjë e cila realizohet sipas procedurave të parashikuara në Kushtetutë apo në Rregulloren e Kuvendit dhe që i nënshtrohet vendimmarrjes përkatëse. Nga ana tjetër, **dispozita kushtetuese, duke parashikuar shprehjen “është i detyruar” jo vetëm që e vendos Kuvendin në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por njëkohësisht, institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare.**

32. E drejta për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor është parashikuar në Kushtetutë si e drejtë edhe e një të katërtës së anëtarëve të Kuvendit. Ngritja e komisionit me votë të një minorance, apo siç pranohet në doktrinën kushtetuese, nëpërmjet zbatimit të parimit të hetimit me votim pakice, **e forcon në mënyrë të konsiderueshme rolin e komisionit hetimor si një instrument efikas kontrolli.** Në këtë drejtim, e drejta e hetimit parlamentar është zhvilluar në kuptimin e së drejtës të pakicave në parlament, që t’u japë atyre një pushtet më të fortë. E drejta e hetimit realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar dhe detyrave kushtetuese që parlamentarët kryejnë si përfaqësues të popullit për sqarimin apo hulumtimin e hollësishëm në çështjen konkrete<sup>12</sup>.

33. Kjo e drejtë shërben njëkohësisht edhe si një mjet në duart e pakicës parlamentare për të ushtruar kontroll kryesisht kundrejt ekzekutivit dhe për të kërkuar vënien përpara përgjegjësisë të mbajtësve të pushtetit. Në një sistem parlamentar, duke qenë se qeveria formohet nga shumica parlamentare, e cila ka në dorë shumë mjete të tjera ligjore, **e drejta e kontrollit hetimor i është njohur sidomos pakicës, që duke i pasur të kufizuara mjetet e saj, mund ta shndërrojë atë në një instrument të fuqishëm kushtetues.**

34. Kushtetuta, në nenin 77, pika 2, duke njohur të drejtën për të ngritur komisione hetimore, si e drejtë e një të katërtës së deputetëve për të vepruar në mënyrë të pavarur nga shumica parlamentare, nëpërmjet shprehjes “është i detyruar” ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit, duke vendosur një balancë ndërmjet shumicës për të vendosur dhe të drejtës së pakicës së cilësuar<sup>13</sup>.

35. **E drejta e pakicës vetëm për sa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor mbetet një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës.** Njëkohësisht, e drejta e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën e shumicës për të ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin e pakicës, me përjashtim të rasteve, kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohet se preken parimet kushtetuese. Gjithsesi, e drejta e një të katërtës së deputetëve për të ushtruar hetimin parlamentar nuk mund të konsiderohet absolutisht e pakufizuar. **I vetmi kufizim i saj**

<sup>11</sup> Shih për ilustrim vendimin nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>12</sup> Shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>13</sup> Shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

është i lidhur me detyrimin që, objekti i hetimit, të jetë në përputhje me respektimin e parimeve të sanksionuara nga Kushtetuta<sup>14</sup>.

36. Nga ana tjetër, nga një analizë e gjithëanshme dhe interpretuese e nenit 77 të Kushtetutës në raport edhe me norma të tjera, respektimi i parimeve kushtetuese në procedurën për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare nuk cenon të drejtën e pakicës për realizimin e kësaj kompetence kushtetuese. **Kuvendi, në rastet kur kërkohet ngritja e komisionit hetimor nga një e katërta e deputetëve, ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit, por ia nënshtron diskutimit parlamentar shkallën e respektimit të parimeve kushtetuese në objektin e veprimtarisë së tij. Ky debat realizohet me qëllim gjetjen e një konsensusi ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit, deri në arritjen e një vendimmarrje**<sup>15</sup>.

37. Prandaj, kufizimet e lejueshme kushtetuese që kanë të bëjnë me respektimin e parimeve të rëndësishme **fokusohen në objektin e hetimit**, i cili nuk mund të reduktohet nga Kuvendi deri në atë masë sa t'ia bëjë të pamundur komisionit kryerjen e veprimtarisë. Kufizimi që mund t'i bëhet objektit të hetimit me argumentin se nuk respektohen parimet kushtetuese, nuk e bën një vendimmarrje të tillë përfundimtare dhe të pakontrollueshme nga pikëpamja e kushtetutshmërisë, për arsye se do ta vendoste të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare në vlerësimin e shumicës, duke dhunuar në këtë mënyrë ushtrimin normal të kësaj të drejte<sup>16</sup>.

38. Këtë qëndrim nuk e ka mbajtur vetëm Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, por edhe Gjykata Kushtetuese Gjermane, e cila, nëpërmjet jurisprudencës së saj, ka mbrojtur vendosmërisht të drejtat e opozitës, në pozicionin e pakicës parlamentare. Gjykata Kushtetuese Gjermane, ndër të tjera, është shprehur se një opozitë parlamentare efektive përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit të ndarjes së pushteteve në një sistem politik ku i njëjti koalicion kontrollon si Parlamentin ashtu edhe Ekzekutivin. Në një çështje për komisionet parlamentare, iniciuar nga një e katërta e deputetëve, Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur se *“kuptimi kushtetues i të drejtës së pakicës qëndron në garantimin e kontrollit që ushtron Parlamenti mbi Ekzekutivin dhe administratën (...) në një sistem parlamentar nuk është detyra e shumicës parlamentare të monitorojë qeverinë/qeverisjen e vendit por e opozitës dhe si rregull e pakicës parlamentare. Nëse kontrolli parlamentar synon të arrijë qëllimin e tij, e drejta kushtetuese e pakicës parlamentare për të ngritur një komision hetimor nuk duhet të dëmtohet (...) nëse kjo e drejtë dobësohet në mënyrë të padrejtë, pakica privohet nga përdorimi i një mekanizmi garantues, i cili i është besuar jo për interesat e saj, por për interesat e shtetit demokratik”*<sup>17</sup>.

39. Po ashtu, në një vendim tjetër, Gjykata Kushtetuese Gjermane është shprehur se në një regjim parlamentar nuk është shumica ajo që vëzhgon qeverisjen, por kjo konsiderohet tashmë si detyrë e opozitës. Prandaj kjo e drejtë e pakicës për të ngritur komisione hetimore, e garantuar me Kushtetutë, **duhet të mbetet gjithmonë e paprekur**. Me parashikimin e të drejtës për të ngritur komision hetimor nuk është garantuar tërësisht e drejta e kontrollit të pakicës. **Duhet të garantohet edhe ushtrimi i pakufizuar i kësaj të drejte**. Për këtë arsye nuk mund të lejohet ndryshimi ose diktimi i objektit të hetimit pa pëlqimin e pakicës, ndryshe nuk do të kishte kuptim parashikimi nga Kushtetuta i së drejtës së mësipërme, kur ajo nuk arrin të realizohet. Një ndryshim

<sup>14</sup> Shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>15</sup> Shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>16</sup> Shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>17</sup> Shih vendimin Schlesëig-Holstein Investigative Committee (1978) 49 BVerfGE 70

i objektit të hetimit mund të sjellë pasoja të rënda për punën e komisionit duke rrezikuar kështu efektivitetin e tij<sup>18</sup>.

40. Duke ju referuar gjithmonë eksperiencës gjermane, në aspektin doktrinar, ka mbizotëruar mendimi se vendimi për ngritjen e komisionit hetimor nuk është i domosdoshëm në vetvete, por marrja e tij (vendimit) ka më shumë për qëllim që të ndezë debatet në parlament, veçanërisht nga shumica e tij, lidhur me kushtetutshmërinë e kërkesës duke i dhënë mundësi pakicës parlamentare të ndryshojë formulimin e kërkesës, nëse shihet si e nevojshme. Vendimi, në çdo rast, duhet të merret në favor të krijimit të komisionit hetimor.

41. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, lidhur me të drejtën e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, ka arritur në konkluzionin se kjo e drejtë është një kompetencë kushtetuese e detyrueshme për t'u respektuar dhe që nuk mund të cenohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare, me përjashtim të rasteve të mosrespektimit të parimeve kushtetuese<sup>19</sup>.

42. Me qëllim që objekti i hetimit të respektojë parimet dhe standardet kushtetuese, duhet të përmbushen këto kushte: (i) çështja duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat ai është i autorizuar të marrë masa ligjore; (ii) objekti i hetimit duhet të fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; (iii) duhet të ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështjeje, për të cilën është i nevojshëm hetimi<sup>20</sup>. Përveç sa më sipër, nga Gjykata Kushtetuese është identifikuar edhe një kusht tjetër, sipas të cilit shumica parlamentare, në rastet kur pretendon se cenohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit, **është e detyruar të propozojë formulime alternative, duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj**<sup>21</sup>.

43. Në përfundim, në rastin konkret, **Kuvendi i Shqipërisë, qartësisht ka shkelur të drejtën kushtetuese të pakicës parlamentare për të kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor, në kundërshtim me nenet 7 dhe 77 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.** Duke refuzuar me votë ngritjen e Komisioneve Hetimore, pa ofruar asnjë “*formulim alternativ*”, Kuvendi i Shqipërisë, përmes vendimeve nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026, jo vetëm ka krijuar konflikt kompetencash, por ka cenuar edhe nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës, që lidhen me standardin e forcës detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Në kuptim të neneve 124 dhe 132 të Kushtetutës, zbatimi i këtyre vendimeve është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme, janë përfundimtare dhe si të tilla përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit<sup>22</sup>. Rezulton e provuar që çështja është e vecantë dhe i referohet veprimtarisë së një subjekti të vencatë (ARRSH apo AKSHI-t), duke e bërë objektin e saj konkret dhe duke u bazuar në indiciet që përmenden në përmbajtjen e kërkesave për ngritjen e të dy Komisioneve Hetimore.

<sup>18</sup> Shih vendimin BverfGE 49, 70ff, të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

<sup>19</sup> Shih vendimin nr. 20, datë 04.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>20</sup> Shih vendimet nr. 22, datë 05.05.2010; nr. 20, datë 04.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>21</sup> Shih vendimin nr. 30, datë 16.05.2014 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>22</sup> Shih vendimet nr. 10, datë 04.03.2021; nr. 49, datë 03.07.2017; nr. 15, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese

***III/3. Përmbledhje e arsyeve për të kundërshtur përpara Gjykatës Kushtetuese vendimet nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026 të Kuvendit të Shqipërisë dhe për të kërkuar zgjidhjen e konfliktit të kompetencave***

44. Në mënyrë të përmbledhur vendimet nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026 të Kuvendit të Shqipërisë, bien ndesh me nenet 7, 77, 124 dhe 132 të Kushtetutës, për shkak se:

44.1. Një e katërta e deputetëve përbën subjekt kushtetues, të cilit vullneti i shumicës parlamentare nuk mund t'i kufizojë ushtrimin e kompetencës kushtetuese për ngritjen e komisionit hetimor parlamentar. Pengimi i kësaj kompetence përbën konflikt kushtetues kompetence dhe legjitimon kërkuar për të kërkuar zgjidhjen e saj.

44.2. Kuvendi duke vendosur mospranimin e kërkesës për ngritjen e dy Komisioneve Hetimor ka cenuar pushtetin e pakicës parlamentare të sanksionuar në nenin 77, pika 2 të Kushtetutës. E drejta e pakicës për të kërkuar ngritjen e komisionit hetimor është e pakufizuar nga vullneti i shumicës dhe sipas parashikimit kushtetues, Kuvendi është i detyruar të caktojë komision hetimi.

44.3. Kërkesa e pakicës parlamentare ka pasur për objekt hetimin parlamentar për të kontrolluar zbatimin e legjislacionit në fuqi në veprimtarinë e Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e disa investimeve në infrastrukturën rrugore, apo kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend anëtar i NATO-s, me qëllim që të nxirren përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit apo korigjimit të ligjeve të veçanta si dhe për të parandaluar dhe eliminuar fenomenet negativ në të ardhmen.

44.4. Qëllimi i punës së Komisionit Hetimor konsiston në një hetim të tillë që përfshihet qartësisht në funksionin e pushtetit legjislativ (mbikëqyrja për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik), pa cenuar kompetencat e pushteteve të tjera.

44.5. Kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor parlamentar respekton konceptin kushtetues “çështje e veçantë”, pasi në këtë koncept përfshihen çështje të hetimit të trajtuara në aspektin e kontrollit dhe zbatimit të ligjit, të njohjes dhe verifikimit të një ngjarjeje, a veprimtarie dhe që nxisin iniciativat për propozime e miratime ligjesh, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shtetin dhe shoqërinë.

44.6. Objekti i hetimit të Komisionit Hetimor, në të dyja kërkesat fokusohet në një çështje konkrete, (*veprimtarinë dhe funksionimin mbi aspekte konkrete të dy subjekteve të veçanta dhe konkrete - dy institucioneve shtetërore/ARRSH dhe AKSHI*), çështje për të cilat ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për një veprimtari që cenon interesin publik.

44.7. Kuvendi ka vendosur mosngritjen e dy Komisioneve Hetimore, pa dhënë asnjë argument kushtetues, pa ngritur asnjë pretendim për objektin e hetimit, dhe mbi të gjitha pa ofruar asnjë “formulim alternativ”.

***III/4. Lidhur me antikushtetutshmërinë e vendimeve nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026 të Kuvendit dhe që janë shkak i krijimit të mosmarrëveshjes së kompetencave midis pakicës parlamentare***

***dhe Kuvendit të Shqipërisë, si dhe mungesën e argumenteve kushtetuese të mazhorancës për rrëzimin e kërkesave për ngritjen e dy Komisioneve Hetimore***

45. Sikurse theksuam në pjesën hyrëse të kësaj kërkesë, mazhoranca në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve të datës 07.04.2026 nuk ngriti asnjë pretendim konkret lidhur me objektin e hetimit. Kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, mbajti disa qëndrime të përgjithshme, pa specifikuar asnjë shqetësim konkret dhe pa ofruar asnjë bashkëpunim.

46. Ndërkohë, në seancën e datës 09.04.2026, mazhoranca mbajti qëndrimet si më poshtë:

*a. Lidhur me kërkesën nr. 1404 prot., datë 01.04.2026<sup>23</sup>:*

*“Në fakt, ishte e mjaftueshme fjala e zotit Blushi për të kuptuar se nuk kemi të bëjmë me një kërkesë për një komision hetimor. Mund të jetë çdo gjë tjetër, por jo një kërkesë për një komision hetimor, siç pretendohet në grupin prej 39 deputetësh, të cilët kanë kërkuar ngritjen e një komisioni hetimor parlamentar “Për kontrollit e ligjshmërisë së veprimeve dhe të mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”, mjafton kjo fjali për të kuptuar që jemi jashtë parlamentarizmit, por po shkojmë në marrjen e kompetencave të autoriteteve të tjera.*

*Në kërkesën në fjalë, e cila merr shkak nga dëmtimet në akset rrugore, të cilat, sipas kërkuësve identifikohen si të jashtëzakonshme, dhe më pas shkohet për një periudhë kohore 12-vjeçare nga viti 2014 në vitin 2025, në fakt, edhe për një kohë kur Autoriteti Rrugor Shqiptar është drejtuar nga një kandidat për deputet i Lëvizjes Socialiste për Integrim asokohe dhe ministria nga kolegu im i nderuar, zoti Haxhinasto. Megjithatë, nuk është kjo çështja.*

*Do t'i referohem më shumë jurisprudencës së pasur sa i përket mënyrës se si formulohen kërkesat për komision hetimor, sepse nga ajo që është thënë synohet që të zbardhen plotësisht. Po e citoj: “Të gjitha veprimet e mosveprimet e institucioneve përgjegjëse në realizimin e veprave të tilla, nxjerrjen e rekomandimeve për organet kompetente, të merren masa...” e të tjera. Kjo është kërkesa, kaq mjafton për kërkesën.*

*E para, në bindjen tonë, mbi të cilën motivojmë votimin kundër kësaj kërkesë, kërkesa juaj bie ndesh zoti Blushi me nenin 77, që ju cituat, shoqëruar kjo me jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese shqiptare dhe praktikën kushtetuese të parlamenteve të vendeve anëtare të Bashkimit Europian. Neni 77 i Kushtetutës me të vërtetë parashikon se: “Kuvendi me kërkesë të 1/4-ës së të gjithë anëtarëve të tij është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë”, por në vijim thuhet: “Komisionet hetimore veprojnë, sipas procedurës së parashikuar në ligj”.*

*Sipas kësaj jurisprudence kushtetuese, e konsoliduar në disa vendime të Gjykatës Kushtetuese, e drejta hetimit realizohet vetëm brenda funksionit të kontrollit parlamentar. Nuk mund të marrë Kuvendi hetim penal. Më tej thuhet: “Dhe detyrave kushtetuese që parlamentarët kryejnë si përfaqësues të popullit për sqarim, hulumtim të hollësishëm në çështje konkrete”.*

*Nuk janë deputetët prokurorë dhe as gjyqtarë. “E drejta e pakicës vetëm sa i përket kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor mbetet një e drejtë e pakufizuar nga vullneti i shumicës, njëkohësisht kjo e drejtë e pakicës për të disponuar mbi objektin e hetimit e kufizon kompetencën, tonën, atë të shumicës, për ta ndryshuar këtë objekt pa pëlqimin edhe tuajin”. Pra, duhet një proces mes të dyja palëve me përjashtim të rasteve “kur nga qëllimi dhe objekti i hetimit konstatohen se preken parimet kushtetuese”, si në rastin në shqyrtim.*

*E drejta juaj, pra e 1/4-ës së deputetëve për ta ushtruar hetimin parlamentar nuk mund të konsiderohet absolutisht e pakufizuar, sepse kufizimi i saj është i lidhur me detyrimin që objekti i hetimit të jetë në përputhje me respektimin e parimeve të sanksionuara nga Kushtetuta, dhe ekzistenca e një kufizimi të tillë, edhe pse nuk përmendet në nenin 77 të Kushtetutës, është e kuptueshme, sepse aty buron edhe vetë dispozita dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.*

<sup>23</sup> Shiko procesverbalin e seancës plenare, datë 09.04.2026, faqe 115-117, qëndrimi i mazhorancës i paraqitur nga Kryetari i Grupit Taulant Balla.

Në rastin e kërkesës, **pakica parlamentare haptazi ka marrë, e para, kompetenca të prokurorisë**, sepse thotë dhe kërkon “që personat përgjegjës të marrin përgjegjësitë përkatëse ligjore”. Pra, ju vini me një kërkesë për një komision hetimor parlamentar ku keni parashikuar që ekzistojnë faktet penale dhe për këto fakte penale duhet të merren përgjegjësitë. Nuk e kemi këtë kompetencë.

E dyta, **doni të merrni edhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit** kur thoni se, shpallni madje, e keni shkruar: “Qëllimi i komisionit hetimor që kërkohet të krijohet mbi bazën e kësaj kërkesë synon të mbledhë informacione të hollësishme mbi mënyrën e realizimit të investimeve...”. Këtë ia kemi dhënë Kontrollit të Lartë të Shtetit, ose ta shkrijmë Kontrollin e Lartë të Shtetit se nuk na duhet, sepse do ta bëjmë vetë. E kemi deleguar, është kompetencë e deleguar, edhe mbi një parim, atë ndarjes së pushteteve sepse tek emërimi i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit përfshihet edhe Presidenti i Republikës, një kompetencë që ia kemi dhënë përmes dekretit. E vërteta është se është një institucion i domosdoshëm.

Sa u përket çështjeve të tjera: “Ushtrimi i funksionit të hetimit parlamentar nuk mund të realizohet në ndërhyrje të kompetencave të institucioneve të tjera. Natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëjlojtë dhe nuk mund të bazohet në hetimin që realizojnë në bazë të ligjit organe të tjera”. Kisha shumë për të thënë për këtë pjesë, sepse realisht na duhet një debat i gjatë për këtë, por, meqenëse koha është e kufizuar dua të sjell sot në vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë eksperiencën e një parlamenti tjetër, kësaj radhe jo të Bundestagut, edhe pse i referohem shpesh, por të parlamentit italian.

Në parlamentin italian komisionet hetimore janë dy llojesh, ose politike, ose legjislativë. Komisionet hetimore politike, si ky që synoni ju të ngrini sot me kërkesën e 39 deputetëve, synojnë të njohin mënyrën e veprimit “la gestione” të qeverisë ose të administratës publike në disa rrethana të caktuara precize, po e theksoj fjalën “precize”. Prandaj, Gjykata jonë Kushtetuese në vendimet 18, 20 dhe 21 të vitit 2003 (janë tre vendime, por i bëra bashkë) e ka sanksionuar nevojën e çështjes së veçantë dhe ne çështjen e veçantë pastaj e kemi transpozuar në ndryshimet që kemi bërë në ligjin “Për komisionet hetimore”. Cila është çështja e veçantë që sillni ju? Asnjë çështje të veçantë në kërkesën tuaj.

Sipas jurisprudencës kushtetuese italiane “Komisionet hetimore politike janë të ligjshme vetëm kur synojnë të njohin mënyrën e ushtrimit të funksionit qeverisës në rrethana konkrete, të identifikueshme, edhe të gjithë të tjerët deri në vitin 2026”. **Mungon çështja precize, çështja e veçantë, për të cilën e kemi futur në ligj.** Kjo do të thotë se objekt i hetimit duhet të jetë një ngjarje, një fenomen apo një sjellje administrative e identifikueshme qartë për të cilën duhet ta ngremë komisionin.

Specifika kohore. **Komisioni nuk mund të hetojë në periudhë të papërcaktuar, duhet të ekzistojë edhe një kuadër kohor i qartë** dhe lidhja me funksionin ekzekutiv. “Hetimi duhet të drejtohet ndaj veprimtarisë së qeverisë administrative”.

Këtë pastaj nuk duhet ta harrojmë asnjëherë se **komisioni hetimor është parë si i treti në radhën e kontrollit parlamentar, pra janë pyetjet, interpelancat, mocionet me debat, në kuptimin e ushtrimit të kompetencës së Parlamentit dhe komisioni hetimor parlamentar si i fundit.**

Dhe komisionet hetimore parlamentare nuk duhet të cenojnë atë që është thelbi i çdo gjëje dhe i arsyes se çfarë roli kemi ne këtu, që është ndarja dhe balancimi i pushteteve. **Nuk mund të marrë komisioni hetimor parlamentar kompetencat e një pushteti tjetër, prandaj parimi themelor, të cilin jua thashë edhe në Konferencën e Kryetarëve, është ndalimi i procesit paralel. Ne nuk mund të kthehemi në një gjykatë alternative apo në një prokurori alternative, por duhet të ndalim dublikimin e hetimit penal dhe natyrisht duhet që të respektojmë një proces, i cili është ndërkohë duke u zhvilluar në një pushtet tjetër, që është pushteti i drejtësisë.**

Prandaj, jo me shaka, por duke cituar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, jua thashë, hiqni dorë nga komisionet hetimore së formës së një ekspedite peshkimi. Duhet të vini këtu me gjëra konkrete, sepse mund të qëllojë që niseni për peshkim, por nuk keni as grepa, lëre më pastaj po të ketë peshk aty ku doni ju të zini peshk.”

47. Nga analiza e këtij qëndrimi, pretendimet e mazhorancës mund të grupohen si më poshtë:

**47.1. Pretendimi 1:** Nuk mund të marrë komisioni hetimor parlamentar kompetencat e një pushteti tjetër, prandaj parimi themelor, të cilin jua thashë edhe në Konferencën e Kryetarëve, është ndalimi i procesit paralel. Ne nuk mund të kthehemi në një gjykatë alternative apo në një prokurori alternative. Pakica parlamentare haptazi ka marrë, e para, kompetenca të prokurorisë, dhe e dyta, doni të merrni edhe kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit.

**Ky pretendim antikushtetues nuk qëndron për këtë arsye:**

Citimi në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është i pasaktë dhe se kjo e fundit ka përcaktuar krejt të kundërtën e asaj që përmendet. Konkretisht, në vendimin e saj nr. 30/2014, Gjykata Kushtetuese ka specifikuar se: **“Gjykata çmon se përderisa pushteti i pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në dyshim, fakti se një çështje e ngjashme po hetohet nga prokuroria nuk krijon pengesë *a priori* në ngritjen e tij. Është detyrë e komisionit hetimor dhe e Kuvendit, që pas ngritjes së Komisionit, të përqendrohen në objektin e hetimit parlamentar, në mënyrë të tillë që të shmanget çdo ndërhyrje në veprimtarinë e organit të prokurorisë, në rastin konkret, apo të organeve të tjera shtetërore, nëpërmjet dublimit apo zëvendësimit të kompetencave, gjë që mund të krijonte një situatë konflikti kompetencash midis tyre. Këtë qëndrim ka mbajtur kjo Gjykatë edhe në vendimin nr. 20, datë 04.05.2007. Komisionet hetimore parlamentare dhe Prokuroria ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Këto organe mund të ndihmojnë, por në asnjë rast nuk mund të zëvendësojnë apo spostojnë njëra – tjetrën, në respekt të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.”**

Komisionet hetimore parlamentare kanë disa veçori që duhen mbajtur parasysh gjatë funksionimit të tyre. Procedura e hetimit parlamentar i shërben qëllimeve të ndryshme nga ato të hetimit penal. Në procesin penal qëllimi është të provohet nëse kryerja e një vepre penale të caktuar ka ardhur si pasojë e veprimit të një personi të caktuar dhe midis këtyre të dyjave ekziston një lidhje shkakësore që provon fajin individual të autorit. Ndërsa në hetimin parlamentar fokusi është evidentimi dhe shpjegimi/sqarimi i një sjellje mbështetur mbi motive politike, para së gjithash për të realizuar efektivisht funksionin kontrollues të parlamentit. Marrja e secilës provë gjatë një hetimi parlamentar nuk është e nevojshme të lidhet patjetër me një fakt të caktuar, por mund të ketë një funksion më të përgjithshëm. p.sh. për të hedhur “dritë në errësirë” gjatë një hetimi kompleks me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë politike. Kufiri i hetimit parlamentar shkon deri në atë pikë ku marrja e provave ose fakteve bëhet pa ndonjë bazë të caktuar dhe nuk ka qëllim të evidentueshëm qartë të cilit do të mund t’i shërbejë<sup>24</sup>.

Eksperiencia italiane, në praktikë, ofron raste të ngjashme. Konkretisht, Parlamenti italian ka miratuar ngritjen e komisioneve hetimore edhe kur i njëjti fenomen ka qenë nën hetim nga organet e Prokurorisë, si në rastet e shumta të hetimit parlamentar mbi fenomenin e krimit të organizuar dhe të mafies apo mbi fenomenin e aktivitetit të kundërligjshëm lidhur me riciklimin e mbetjeve<sup>25</sup>. Në këtë drejtim, hetimi parlamentar ka pasur si qëllim dhe ka rekomanduar përmirësimin e legjislacionit apo ndërhyrje me ligje të veçanta në fusha të ndryshme në varësi të fenomeneve të hetuara dhe si pjesë të relacionit të paraqitur në Parlament nga komisionet e ngritura janë bërë edhe aktet e organeve gjyqësore si dhe të Prokurorisë.

<sup>24</sup> Shih vendimin BVerfG, 2 BvE 3/07, datë 17.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

<sup>25</sup> Shih komisionet hetimore të ngritura me ligjet nr. 646/1982; nr. 94/1988; nr. 229/1991; nr. 356/1992; nr. 430/1994; nr. 509/1996; nr. 386/2001; nr. 277/2006 nr. 132/2008, nr. 6/2009 dhe nr. 87/2013.

Duke ju kthyer rastit konkret, nisur nga qëllimi dhe objekti i Komisionit Hetimor të kërkuar, vërehet qartësisht se nuk kemi të bëjmë me ndonjë përpjekje të pakicës që parlamenti të përvetësojë kompetencën e prokurorisë për të ndjekur vetë penalisht apo për të kryer vetë hetime mbi çështjen konkrete. Aq më pak për të marrë kompetencat e Kontrollit të Lartë të Shtetit, që sipas Kushtetutës<sup>26</sup>, kontrollon: “a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë; b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor; c) veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti”. Këtë mundësi, pakica parlamentare e ka përjashtuar vetë në kërkesën që i ka drejtuar Kuvendit kur ka deklaruar se hetimi nuk do të konsistojë në nxjerrjen e përgjegjësisë penale për personat e përfshirë në këtë fenomen dhe as do të mbivendoset me kompetencat e organeve të tjera (shiko fq. 4 të kërkesës dhe pikën III të projektvendimit shoqëruar). Pra, Komisioni nuk kërkon të hetojë mbi çështjet për të cilat ka filluar procedimi penal. Ajo që kërkohet të hetohet është çështja se sa efikas dhe të përgjegjshëm kanë qenë institucionet e shtetit në kryerjen e detyrës së tyre. Si përfundim, natyra e hetimit parlamentar që kërkohet të kryhet nuk është e njëlojtë dhe nuk mund të barazohet me objektin e hetimit të organit të prokurorisë apo organeve të tjera Kushtetuese.

47.2. **Prendimi 2:** Mungon çështja precize, çështja e veçantë. Kjo do të thotë se objekt i hetimit duhet të jetë një ngjarje, një fenomen apo një sjellje administrative e identifikueshme qartë për të cilën duhet ta ngremë komisionin. Komisioni nuk mund të hetojë në periudhë të papërcaktuar, duhet të ekzistojë edhe një kuadër kohor i qartë.

### **Ky pretendim antikushtetues nuk qëndron për këtë arsye:**

Në kërkesë janë evidentuar rastet konkrete që kërkohet të hetohet, përfshirë edhe periudhën e shtrirjes së hetimit. Konkretisht në kërkesë evidentohet se: “*Dëmtime serioze patën segmentet Librazhd-Prrenjas, Qukës-Qafë Plloçë, Korçë-Ersekë, Unaza e Burrelit, Auro-moto-parku Elbasan, Dardhë-Boboshticë, Vllahinë-Poçem, Lurë-Peshkopi, Kuç-Qeparo, Memaliaj-Tepelenë, Shëngjin-Velipojë, Tuneli i Llogarasë, Tuneli i Murrizit. Një rëndësie të veçantë është segmenti Librazhd - Prrenjas, si pjesë e aksit Jug-Lindor dhe pjesë e Korridorit Ndërkombëtar VIII, pjesë e Korridoreve rrugore Evropiane. Këto dëmtime të akseve rrugore kanë qenë me pasoja të jashtëzakonshme për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, për transportin kombëtar e ndërkombëtar, si dhe për ekonominë në përgjithësi. Gjatë kësaj periudhe, mjaft inxhinierë dhe specialistë të ndërtimit të rrugëve kanë shprehur publikisht vërejtjet e tyre për mënyrën si realizohen këto vepra publike, duke nënvizuar probleme që kanë të bëjnë me projektet, me studimet gjeologjike, me supervizimin dhe inspektimin e punimeve, me respektimin kritereve të sigurisë dhe të mirëmbajtjes, si dhe me respektimin e standardeve të vetë ndërtimit. Gjatë periudhës 2014-2025 janë investuar në infrastrukturen rrugore rreth 4 miliard euro, një vlerë shumë e lartë e investimeve publike. Këto vlera të larta të përdorimit të parave të taksapaguesve janë një detyrim i rëndësishëm për tu mirembajtur dhe për të gjetur e analizuar gjithë faktorët e amortizimit të shpejtë të tyre, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe rentabilitetit të investimeve sot dhe në të ardhmen. Në këtë kuptim, ngritja e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar ka për qëllim që të zbardhë plotësisht të gjitha veprimet dhe mosveprimet institucioneve përgjegjëse në realizimin e veprave të tilla, si dhe nxjerrjen e rekomandimeve për organet kompetente që personat përgjegjës të marrin përgjegjësitë*

<sup>26</sup> Nenet 162 e vijues të Kushtetutës

*përkatese ligjore, si dhe të merren masat e përshtatshme që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.”. Pra ndryshe ngasa pretendon mazhoranca, në kërkesë janë të specifikuar “çështja e vecantë” – listimi i akteve rrugore që duhet të verifikohen, si dhe periudha e ndërtimit të tyre – 2014-2025.*

47.3. **Pretendimi 3:** Komisioni Hetimor është parë si i treti në radhën e kontrollit parlamentar, pra janë pyetjet, interpelancat, mocionet me debat, në kuptimin e ushtrimit të kompetencës së Parlamentit dhe komisioni hetimor parlamentar si i fundit.

### **Ky pretendim antikushtetues nuk qëndron për këtë arsye:**

Nuk ekziston asnjë kusht kushtetues apo ligjor, që kërkuesi duhet të ketë ezauruar një mekanizëm tjetër të kontrollit parlamentar, përpara se të kërkojë ngritjen e një Komisioni Hetimor. Rradha e mekanizmave të kontrollit është një shpikje ekstrakushtetuese e mazhorancës, për shkak se përzgjedhja e mekanizmit me efikas të kontrollit parlamentar është një e drejtë ekskluzive e kërkuesit. Për pasojë, pretendimi nuk ka asnjë bazë kushtetuese dhe për pasojë është haptazi i papranueshëm.

48. Fakti që pretendimet e mazhorancës nuk qëndrojnë janë prezantuar nga pakica parlamentare gjatë procedurës parlamentare, duke i ftuar deputetët e mazhorancës që nëse kanë pretendime mbi objektin e hetimit, të bëjnë formulime alternative dhe kërkuesit janë të gatshëm të reflektojnë çdo shqetësim. Konkretisht, qëndrimi i kërkuesit gjatë procedurës parlamentare, ka qenë si më poshtë:

*“Së pari, do të ishte mirë që, kur citojmë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, t’i citojmë ashtu siç janë. Nuk ekziston asnjë vendim i Gjykatës Kushtetuese, që e pengon Kuvendin të kryejë hetim parlamentar për çështje që organet e tjera kushtetuese brenda fushës së tyre të kompetencave, në rastin konkret prokuroria apo gjykata, janë duke hetuar apo duke gjykuar. E kundërta e kësaj është e vërtetë. Gjykata Kushtetuese në rastin e vendimit nr. 30 të vitit 2014, ku kërkohej hetim për skandalin e vjedhjes së të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Mazhoranca, që përkon me mazhorancën aktuale, e refuzoi ngritjen e komisionit hetimor me pretendimin që çështja po gjykohej dhe po hetohej nga prokuroria.*

*Ka një vendim të Gjykatës Kushtetuese, i cili ka thënë të kundërtën e asaj që tha zoti Balla. Fakti që organet e tjera kushtetuese kryejnë apo përmbushin përgjegjësitë e tyre kushtetuese, në rastin konkret të hetimit penal, nuk mund të shërbejë kurrë si argument për të refuzuar ushtrimin e përgjegjësisë kushtetuese nga ana e Kuvendit për të kryer hetim parlamentar.*

*Së dyti, në dijeninë time, por besoj se ka edhe deklarata publike të zotit Balla, ju keni ndërhyrë dy herë në ligjin për komisionet hetimore, gjoja për të reflektuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Pra, pretendimi juaj është që çdo vendim i Gjykatës Kushtetuese, që ka dalë deri më tani, gjen pasqyrim në ligjin e ndryshuar të komisioneve hetimore. Kështu që, në rastin konkret ne do të duhet t’i referohemi ligjit, i cili thotë që ngritja e komisionit hetimor është e detyrueshme, duke verifikuar tri rrethana.*

*Çështja do të duhet të ketë të bëjë me funksionin ligjvënës apo funksione të tjera, pra të kontrollit parlamentar nga ana e Kuvendit. Nëse shikohet objekti i punës së komisionit, cituar në kërkesë, por edhe në projektvendimin që citohet, ne kemi kërkuar të verifikohet ligjshmëria e veprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar lidhur me projektet që përmenden në kërkesë dhe që e bëjnë çështjen më shumë sesa konkrete. Bëhet fjalë për dëmtimet në segmentet: Librazhd – Përrenjas, Qukës – Qafë Plloçë, Korçë – Ersekë; unaza e Burrelit, automotoparku në Elbasan, Dardhë – Boboshticë, Vllahinë – Poçëm, Lurë– Peshkopi, Kuç – Qeparo, Memaliaj – Tepelenë, Shëngjin – Velipojë, tuneli i Llogarasë, tuneli i Murrizit.*

*Këto janë veprat që përmenden në kërkesë dhe ne kërkojmë që të verifikohet ligjshmëria e veprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar, duke kryer të gjitha testimet e nevojshme, pra kontrollet e nevojshme nëse janë*

respektuar apo jo standardet e ndërtimit të rrugëve nga kompanitë përkatëse, që do të duhet të jenë marrë në dorëzim dhe që janë pranuar edhe nga Autoriteti Rrugor Shqiptar; të kryejmë një verifikim dhe kontroll të kapaciteteve institucionale, në funksion të garantimit të standardeve më të larta të projektimit dhe të zbatimit të veprave publike, pra për të verifikuar nevojat që ka ARRSH-ja, nëse burimet e saj njerëzore janë të mjaftueshme apo jo dhe, sigurisht, në përmbushje të funksionit tonë kushtetues, pra jo si organ hetimi penal, por si organ që rekomandon apo konstaton çështje që lidhen me organet e pushtetit ekzekutiv, të bëjmë rekomandime edhe për përmirësime qoftë të legjislacionit, qoftë të punës organizative të ARRSH-së.

Kushti i tretë i vendosur nga ligji është që do të duhet të ekzistojnë të dhëna dhe indicie të mjaftueshme për objektin e kërkimit. Në rastin konkret, besoj se biem të gjithë dakord që të dhënat dhe indiciet i kemi parë të gjithë, pra dëmtimi i këtyre rrugëve është një fakt i njohur botërisht, që nuk ka nevojë as të provohet, sepse ne kemi qenë të gjithë dëshmitarë, të paktën në një nga segmentet, ku për 10 ditë në të gjithë Juglindjen e vendit u pezullua apo u pengua qarkullimi i lirë i qytetarëve.

Pra, të gjitha kërkesat që përcakton neni 5 i ligjit, janë tërësisht të përmbushura nga kërkesa që ne kemi përpara.

E drejta e 1/5-ës, pra e 35 deputetëve është e pakushtëzuar nga vullneti i mazhorancës, këtë e thotë Gjykata Kushtetuese dhe, po, është e kufizuar vetëm në një rast: në qoftë se ju keni pretendime për objektin. Në atë rast Gjykata Kushtetuese ka vendosur një kusht: do të duhet të bëni formulim alternativ.

Kështu, edhe në emër të të gjithë deputetëve nënshkrues, ju ftojme të na bëni një propozim apo formulim alternativ për objektin, nëse e keni një të tillë, sepse ky është i vetmi detyrim që kemi për t'ju dëgjuar: në qoftë se keni një pretendim për objektin dhe doni të bëni formulime alternative. Ne jemi të hapur t'ju dëgjojmë, ta marrim në shqyrtim propozimin apo formulimin tuaj alternativ, pa asnjë paragjykim. Edhe në këtë rast ka një kusht të tretë, që jua vendos Gjykata Kushtetuese: riformulimi i objektit që do të bëni, nuk do të duhet që të jetë i tillë, sa të pengojë punën e komisionit hetimor të kërkuar nga opozita.

Unë nuk dëgjova që ju të kishit pretendime për objektin, nuk dëgjova që të kishit një formulim alternativ. Meqenëse fjala do t'i kalojë një deputeti të mazhorancës në këtë moment, mirëpresim formulimin tuaj alternativ në raport me objektin, si kusht i vendosur nga Gjykata Kushtetuese."<sup>27</sup>

Pra, qartësisht qëndrimi i shprehur nga mazhoranca nuk përben argument kushtetues për të refuzuar një të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare. Për pasojë, shkak i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit duhet kërkuar te mohimi, nga ky i fundit (Kuvendi), i kompetencës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, me argumentin jokushtetues, përfshirë argumentin se një çështje e ngjashme mund të hetohet nga prokuroria.

#### b. Lidhur me kërkesën nr. 1440 Prot., datë 03.04.2026

"Tejkalimi në kohë edhe në argumente i fjalës së parafolësit, po ashtu, është një përgjigje për një nga argumentet bazë pse në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve u votua kundër nga mazhoranca.

E para, totalisht dalë nga fokusi në një tejzgjatje dhe aspak me një fokus specifik, siç kërkohet për çdo kërkesë që ngrihet me të drejtë nga pakica parlamentare, nga opozita, e cila për të pestën herë radhazi, në gjashtë muajt e kësaj legjislature, nuk ka bërë asgjë tjetër veçse ka sjellë një fokus të gjerë, aspak specifik dhe komplet të shpërndarë, sikurse edhe fjala e parafolësit.

Sigurisht, **Gjykata Kushtetuese në këtë drejtim ka qenë shumë e qartë, specifikisht ka shprehur që duhet të vihet me çështje konkrete.** Çështjet konkrete, në këtë rast, nuk fillojnë nga prokurimi te funksionaliteti dhe te

<sup>27</sup> Shiko procesverbalin e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, datë 07.04.2026, faqe 20-22, qëndrimi i pakicës parlamentare i paraqitur nga Kryetari i Grupit Parlamentar të PD Gazment Bardhi.

*çështje, që për arsye të parimit të dytë dhe përsëri në referencë të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi nuk mundet të vihet në pozicion për të mbivënë rolin e një pushteti tjetër, që është duke gjykuar këtë çështje.*

*Për të dyja këto arsye, për të dyja këto parime kemi diskutuar në mbledhjen më të fundit të Konferencës së Kryetarëve, për të shprehur që, po, është legjitime kërkesa për të ngritur një komision hetimor, por duhet të jetë, edhe një herë, specifike dhe, e dyta, duhet që Kuvendi të mos vihet në pozicionin dhe mbivënien me një pushtet tjetër, atë të gjyqësorit.*

*Të gjitha provat dhe faktet, ato që ju i cituat apo të tjera që mund t'i citoni në vijim, duhet t'i drejtohen organit të drejtësisë, i cili është duke hetuar mbi çështjen. Derisa organi i drejtësisë të shprehet, nuk mendojmë që komisioni hetimor duhet të mbivihet mbi këtë funksion.*

*Kërkesa për ngritjen e një komisioni hetimor është më shumë se çdo gjë tjetër një propagandë, qoftë dhe në orët e vona të kësaj dite të enjte. Prandaj, përsëri si mazhorancë kërkojmë që të mos cenohet roli i Kuvendit, duke bërë që të ndërhyjë në një proces ku një pushtet tjetër është i përfshirë. Qartësisht, anëtarët e mazhorancës në Konferencën e Kryetarëve e kanë shprehur mbështetjen ndaj procesit të pranimit të kërkesës për komisione hetimore, por, edhe një herë, duhet të respektohet parimi i të qenit një kërkesë specifike dhe e pambivënë me pushtetet e tjera.*

*Prandaj, edhe në këtë rast, sikurse dhe në rastin e mëparshëm, anëtarët e mazhorancës në Konferencën e Kryetarëve kanë gjykuar që kërkesa duhet të rrëzohet dhe për këtë arsye i kanë propozuar seancës plenare të votohet kundër.”<sup>28</sup>*

49. Nga analiza e këtij qëndrimi, pretendimi i mazhorancës mund të përmbliidhet si më poshtë:

**49.1. Pretendimi 1:** Gjykata Kushtetuese në këtë drejtim ka qenë shumë e qartë, specifikisht ka shprehur që duhet të vihet me çështje konkrete. Çështjet konkrete, në këtë rast, nuk fillojnë nga prokurimi te funksionaliteti dhe te çështje, që për arsye të parimit të dytë dhe përsëri në referencë të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi nuk mundet të vihet në pozicion për të mbivënë rolin e një pushteti tjetër, që është duke gjykuar këtë çështje.

#### **Ky pretendim antikushtetues nuk qëndron për këtë arsye:**

Së pari, kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor plotëson në mënyrë kumulative të tri kushtet kryesore kushtetuese: (i) çështja ka lidhje me funksionin ligjvënës ose me funksione të tjera të Kuvendit – kontrollin e zbatimit të ligjeve; (ii) objekti fokusohet në çështje ose subjekte konkrete – në veprimtarinë e AKSHI-t; (iii) ekzistojnë të dhëna apo indicie të mjaftueshme, të cilat justifikojnë hetimin – kërkesa përmbledh një grup të gjerë faktesh apo indiciesh që justifikojnë hetimin parlamentar.

Së dyti, çështja konkrete është formuluar qartë, në objektin e punës së Komisionit Hetimor, ku qartësisht specifikohet se: “Komisioni ka për objekt të veprimtarisë së tij: i) Verifikimin e ligjshmërisë së procedurave të prokurimit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit që lidhen me bazat e të dhënave shtetërore, për periudhën 1 Janar 2014 – 31 Mars 2026; ii) Verifikimin nëse operatorë ekonomikë të kontraktuar kanë pasur akses në sistemet kritike digjitale dhe në çfarë kushtesh, përfshirë nëse është respektuar vettingu i sigurisë; iii) Analizimin e ndikimit të rrjedhjeve të të dhënave të viteve 2021–2022 në të drejtat e qytetarëve dhe në sigurinë kombëtare, si dhe vlerësimin e përgjegjësisë institucionale për këto incidente; iv) Nxjerrjen e

<sup>28</sup> Shiko procesverbalin e seancës plenare, datë 09.04.2026, faqe 120, qëndrimi i mazhorancës i paraqitur nga Deputetja Anila Denaj.

përgjegjësisë institucionale për emërimin, mbikëqyrjen dhe kontrollin e drejtuesve të AKSHI-t gjatë kësaj periudhe; v) Vlerësimin e respektimit të standardeve të NATO-s për mbrojtjen e infrastrukturës kritike digjitale dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Shqipërisë; vi) Propozimin e masave ligjore dhe institucionale të nevojshme për të garantuar në të ardhmen funksionimin e sigurt dhe transparent të infrastrukturës digjitale shtetërore.”.

Së treti, ritheksojmë se citimi në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është i pasaktë dhe se kjo e fundit ka përcaktuar krejt të kundërtën e asaj që përmendet. Konkretisht, në vendimin e saj nr. 30/2014, Gjykata Kushtetuese ka specifikuar se: **“Gjykata çmon se përderisa pushteti i pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në dyshim, fakti se një çështje e ngjashme po hetohet nga prokuroria nuk krijon pengesë *a priori* në ngritjen e tij. Është detyrë e komisionit hetimor dhe e Kuvendit, që pas ngritjes së Komisionit, të përqendrohen në objektin e hetimit parlamentar, në mënyrë të tillë që të shmanget çdo ndërhyrje në veprimtarinë e organit të prokurorisë, në rastin konkret, apo të organeve të tjera shtetërore, nëpërmjet dublimit apo zëvendësimit të kompetencave, gjë që mund të krijonte një situatë konflikti kompetencash midis tyre. Këtë qëndrim ka mbajtur kjo Gjykatë edhe në vendimin nr. 20, datë 04.05.2007. Komisionet hetimore parlamentare dhe Prokuroria ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri. Këto organe mund të ndihmojnë, por në asnjë rast nuk mund të zëvendësojnë apo spostojnë njëra – tjetrën, në respekt të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.”.**

Komisionet hetimore parlamentare kanë disa veçori që duhen mbajtur parasysh gjatë funksionimit të tyre. Procedura e hetimit parlamentar i shërben qëllimeve të ndryshme nga ato të hetimit penal. Në procesin penal qëllimi është të provohet nëse kryerja e një veprë penale të caktuar ka ardhur si pasojë e veprimit të një personi të caktuar dhe midis këtyre të dyjave ekziston një lidhje shkakësore që provon fajin individual të autorit. Ndërsa në hetimin parlamentar fokusi është evidentimi dhe shpjegimi/sqarimi i një sjellje mbështetur mbi motive politike, para së gjithash për të realizuar efektivisht funksionin kontrollues të parlamentit. Marrja e secilës provë gjatë një hetimi parlamentar nuk është e nevojshme të lidhet patjetër me një fakt të caktuar, por mund të ketë një funksion më të përgjithshëm. p.sh. për të hedhur “dritë në errësirë” gjatë një hetimi kompleks me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë politike. Kufiri i hetimit parlamentar shkon deri në atë pikë ku marrja e provave ose fakteve bëhet pa ndonjë bazë të caktuar dhe nuk ka qëllim të evidentueshëm qartë të cilit do të mund t’i shërbejë<sup>29</sup>.

Eksperiencia italiane, në praktikë, ofron raste të ngjashme. Konkretisht, Parlamenti italian ka miratuar ngritjen e komisioneve hetimore edhe kur i njëjti fenomen ka qenë nën hetim nga organet e Prokurorisë, si në rastet e shumta të hetimit parlamentar mbi fenomenin e krimit të organizuar dhe të mafies apo mbi fenomenin e aktivitetit të kundërligjshëm lidhur me riciklimin e mbetjeve<sup>30</sup>. Në këtë drejtim, hetimi parlamentar ka pasur si qëllim dhe ka rekomanduar përmirësimin e legjislacionit apo ndërhyrje me ligje të veçanta në fusha të ndryshme në varësi të fenomeneve të hetuara dhe si pjesë të relacionit të paraqitur në Parlament nga komisionet e ngritura janë bërë edhe aktet e organeve gjyqësore si dhe të Prokurorisë.

<sup>29</sup> Shih vendimin BVerfG, 2 BvE 3/07, datë 17.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese Federale Gjermane

<sup>30</sup> Shih komisionet hetimore të ngritura me ligjet nr. 646/1982; nr. 94/1988; nr. 229/1991; nr. 356/1992; nr. 430/1994; nr. 509/1996; nr. 386/2001; nr. 277/2006 nr. 132/2008, nr. 6/2009 dhe nr. 87/2013.

Duke ju kthyer rastit konkret, nisur nga qëllimi dhe objekti i Komisionit Hetimor të kërkuar, vërehet qartësisht se nuk kemi të bëjmë me ndonjë përpjekje të pakicës që parlamenti të përvetësojë kompetencën e prokurorisë për të ndjekur vetë penalisht apo për të kryer vetë hetime mbi çështjen konkrete. Këtë mundësi, pakica parlamentare e ka përjashtuar vetë në kërkesën që i ka drejtuar Kuvendit kur ka deklaruar se hetimi nuk do të konsistojë në nxjerrjen e përgjegjësisë penale për personat e përfshirë në këtë fenomen dhe as do të mbivendoset me kompetencat e organeve të tjera (shiko fq. 6 të kërkesës dhe pikën III të projektvendimit shoqërues). Pra, Komisioni nuk kërkon të hetojë mbi çështjet për të cilat ka filluar procedimi penal. Ajo që kërkohet të hetohet është çështja se sa efikas dhe të përgjegjshëm kanë qenë institucionet e shtetit në kryerjen e detyrës së tyre. Si përfundim, natyra e hetimit parlamentar që kërkohet të kryhet nuk është e njëjlojtë dhe nuk mund të barazohet me objektin e hetimit të organit të prokurorisë apo organeve të tjera Kushtetuese.

50. Fakti që pretendimet e mazhorancës nuk qëndrojnë janë prezantuar nga pakica parlamentare gjatë procedurës parlamentare, duke i ftuar deputetët e mazhorancës që nëse kanë pretendime mbi objektin e hetimit, të bëjnë formulime alternative dhe kërkuesit janë të gatshëm të reflektojnë çdo shqetësim. Konkretisht, qëndrimi i kërkuesit gjatë procedurës parlamentare, ka qenë si më poshtë:

*“Së pari, më duhet të nënvizoj, edhe për efekt procesverbali, se nuk dëgjova asnjë konstatim nga kolegët sa i takon formulimit të objektit të kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor, pra objektit të punës së komisionit hetimor, dhe asnjë propozim alternativ nga ana e tyre.*

*Së dyti, dua të sjell në vëmendjen tuaj se kontrolli parlamentar nuk është funksion gjyqësor. Kontrolli parlamentar është përgjegjësi dhe funksion kushtetues i Kuvendit të Shqipërisë. Në asnjë rast dhe në asnjë rrethanë, objekti i punës së komisionit... unë nuk di që Gjykata të jetë duke u marrë me sigurinë kibernetike apo me të dhënat personale të qytetarëve, pra me mënyrën se si ato ruhen dhe administrohen nga Agjencia. Kjo është detyrë e Kuvendit, pra të kontrollojë një institucion të ekzekutivit, për të parë nëse po garanton, po respekton zbatimin korrekt të ligjit dhe standardeve për garantimin e sigurisë kibernetike apo të të dhënave personale të shtetasve.*

*Së treti, është detyrë e Kuvendit të Shqipërisë të kontrollojë zbatimin e legjislacionit përkatës për prokurimet publike, të kryera në institucionin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Nga ana tjetër, të gjitha shqetësimet (që nuk janë shqetësime, por janë justifikime që i ngriti zoti Balla) gjejnë përgjigje në pikën 3 të projektvendimit që ne kemi propozuar, të cilin po e citoj: “Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese të ndarjes së pushteteve, prezumimit të pafajësisë, paanësisë dhe respektimit të jetës private të individit”. Pra, komisioni, sipas asaj që ne kemi propozuar, ka detyrimin, së pari, të mos kryejë asnjë funksion gjyqësor, por të qëndrojë në punën e tij brenda kësaj që ne kemi kërkuar dhe që është funksion kushtetues i Kuvendit të Shqipërisë, pra të ushtrojë kontroll parlamentar dhe, së dyti, të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, atë të paanësisë dhe të respektimit të jetës private.*

*Zoti Kryetar, është fakt i njohur publik, dhe të dhënat janë publike, që mënyra se si është administruar Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka sjellë ngritjen nga prokuroria të një akuze që jemi përpara një grupi të strukturuar kriminal. Unë, si parlamentar, nuk mund të pranoj që të mos ushtroj përgjegjësinë time për të kontrolluar një organ të pushtetit ekzekutiv, që nga prokuroria është cilësuar si grup i strukturuar kriminal. Nëse Kuvendi i Shqipërisë nuk vepron në këtë rast, do të thotë që ne po legjitimojmë shndërrimin e institucioneve publike, organeve publike, në struktura të kriminalizuara, në grupe të strukturuar kriminale, dhe kjo do të duhet të jetë alarmante për Kuvendin e Shqipërisë.*

*Ne nuk çojmë njerëz në burg, në burg i çon gjykata dhe prokuroria, por ne, edhe si mesazh ndaj çdo institucioni tjetër, nuk mund të lejojmë kurrë që një organ publik, dhe jo një organ dosido, por organi që menaxhon të gjitha sistemet e sigurisë në këtë Republikë, organi që menaxhon dhe administron të dhënat personale të të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në këtë Republikë, të sillt si grup i strukturuar kriminal dhe Kuvendi nuk paska të drejtë të ushtrojë kontroll parlamentar për të verifikuar zbatimin e ligjit nga këta nëpunës publikë.*

*Kërkesa ka të dhëna të plota apo indicie, fakte dhe grupfakte, që janë të mjaftueshme për të kërkuar ngritjen e komisionit hetimor. Sigurisht, kërkesa nuk del në përfundime dhe nuk mund të ketë setin e plotë të fakteve, provave dhe rrethanave, sepse për këtë arsye kërkohet ngritja e një komisioni hetimor, por kërkesa përmban indicie të mjaftueshme, fakte dhe grupfakte, mbi të cilat Kuvendi do të duhet dhe ka detyrimin të lejojë ngritjen e një komisioni hetimor.*

*Zoti Kryetar, po jua ripërsëris edhe një herë: nëse opozita në këtë Kuvend nuk ka asnjë mekanizëm, pra nuk lejohet të ushtrojë funksionin e vet kushtetues, në kundërshtim me Kushtetutën dhe Rregulloren, që është ai i kontrollit parlamentar; nëse opozitës nuk i përgjigjen në raport me të drejtën që ajo ka as Kryeministri dhe as ministrat për të ardhur dhe për të dhënë llogari; nëse opozita nuk dikton dot debat apo diskutim për asnjë çështje në agjendën e Kuvendit; nëse iniciativat e deputetëve të opozitës, edhe pse janë punë tërësisht profesionale, rrëzohen thjesht nga urrejtja që ju keni ndaj kundërshtarëve politikë, pra thjesht me argumentin që ne nuk votojmë pro një ligji të sjellë nga një deputet i opozitës, madje e marrim, e kopjojmë dhe pasi e kemi rrëzuar në seancë e risjellim si propozim të Këshillit të Ministrave apo deputetëve të mazhorancës dhe e votojmë, cili është roli i deputetëve të opozitës në Kuvend, ku ju keni vendosur t'u zeroni çdo rol deputetëve?*

*Çfarë kuptimi merr prezenca jonë në Kuvend, zoti Kryetar, kur ju nuk lejoni as mocione me debat, as interpelanca, as seanca dëgjimore, as komisione hetimore, as amendamente të opozitës? Deputetët e opozitës kanë dorëzuar 52 amendamente në 6 muaj, por nuk keni pranuar të diskutoni dhe të miratoni një të vetëm. Deputetët e opozitës kanë propozuar 18 projektligje në 6 muaj, por keni marrë në shqyrtim 10 prej tyre dhe i keni rrëzuar të 10, pa asnjë argument. Atëherë, mund të na thoni se cili është roli ynë, të vijmë dhe t'ju bëjmë fresk ju që të mos ndjeni vapën që po afrohet?*

*Unë e di që përgjegjësia e çdo deputeti është të ushtrojë ato kompetenca dhe funksione që i njej Kushtetuta, por ju me vendimmarrje politike na i mohoni këto të drejta tonat. Na thoni çfarë roli duhet të luajmë ne në Kuvend, se nga njëra anë bëni thirrje për rol konstruktiv të opozitës në Kuvend, dhe kur ne jemi konstruktivë, propozojmë ligje, sjellim mekanizmat apo kërkojmë aplikimin e mekanizmave të kontrollit, ju ngrini kartonin? Dhe pastaj thoni: ne do ta shembim Kushtetutën dhe mënyrën se si është ndërtuar Republika Parlamentare, por integrimin po na e bllokoni ju, se keni shkuar diku atje në një takim, ku ka qenë edhe një kolegia ime, e cila ju ka dëgjuar që keni thënë se Belinda Balluku duhet të shkojë në burg, ndërkohë që vendimi i liderit suprem të partisë sonë është që Belinda Balluku nuk duhet të shkojë në burg, dhe po thatë të kundërtën, ju po punoni kundër Shqipërisë.*

*Kështu, zoti Kryetar, këtë përgjigje e dua nga ju, sepse ju jeni garant. Mbaj mend fjalimin tuaj të parë, keni lexuar një fjalim shumë emocionues, nga i cili jam emocionuar shumë personalisht, ku thatë: do të jem garant i të drejtave të pakicës në Kuvend. Deri më sot, në gjashtë muaj, unë nuk di që t'i keni dalë për zot një të drejtë të opozitës, një të vetme. Madje, edhe në ato që janë vendimmarrjet tuaja personale e keni shkelur me këmbë opozitën; edhe në gjëra nga më banaanet, që tregon mungesë të theksuar ... Pra, kur ju nuk keni minimumin e respektit për opozitën as për gjërat që i keni ju në dorë, ju lutem, na thoni çfarë bëjmë ne në Kuvend, çfarë roli duhet të bëjmë ne në Kuvend? Të vijmë t'ju bëjmë fresk? E duam këtë përgjigje, zoti Kryetar, sepse përgjegjësinë për funksionimin sipas standardeve demokratike të Kuvendit e ka Kryetari i Kuvendit.”<sup>31</sup>.*

Pra, qartësisht qëndrimi i shprehur nga mazhoranca nuk përben argument kushtetues për të refuzuar një të drejtë kushtetuese të pakicës parlamentare. Për pasojë, shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit duhet kërkuar të mohimi, nga ky i fundit (Kuvendi), i kompetencës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, me argumentin jokushtetues, përfshirë argumentin se një çështje e ngjashme po hetohet apo mund të hetohet nga prokuroria.

<sup>31</sup> Shiko procesverbalin e mbledhjes së Konferencës së Kryetarëve, datë 07.04.2026, faqe 32-34, qëndrimi i pakicës parlamentare i paraqitur nga Kryetari i Grupit Parlamentar të PD Gazment Bardhi.

### *III/5. Lidhur me kushtetutshmërinë e objektit të hetimit parlamentar*

51. Në aspektin kushtetues komisioni hetimor është një nga instrumentet e kontrollit me anë të të cilit Kuvendi ushtron dhe perfeksionon pushtetin e tij legjislativ. Qëllimi i ngritjes së komisioneve hetimore është njohja dhe verifikimi i një fenomeni, i një ngjarjeje, apo i një veprimtarie, me synimin për të nxjerrë përfundime mbi nevojën e miratimit, plotësimit, apo korigjimit të ligjeve të veçanta, si dhe për të nxjerrë përgjegjësinë mbi mënyrën e qeverisjes<sup>32</sup>.

52. Megjithatë, në pajtim me jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se kontrolli parlamentar nuk mund të përdoret tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit. Ajo ka vlerësuar se një kompetencë e tillë nuk e transformon Kuvendin në një super-organ të pushtetit të shtetit. Bazuar në parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, demokracia parlamentare nuk është një sistem ku parlamenti mund të ushtrojë kontroll mbi çdo vendim të institucioneve, të nisë procedura për të vendosur sanksione ndaj tyre, apo të marrë vendime në emër të institucioneve që e kanë një kompetencë të tillë. Një interpretim ndryshe i kësaj kompetence kontrolli që i njihet Kuvendit, do të çonte në mohimin e parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve. Prandaj Gjykata Kushtetuese ka arritur në përfundimin se e drejta për të ushtruar hetim parlamentar nuk mund të jetë e pakufizuar. Kufizimi i saj lidhet me detyrimin që objekti i hetimit të respektojë parimet kushtetuese<sup>33</sup>.

53. Lidhur me respektimin e parimeve kushtetuese, në vendimin nr. 18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese me objekt interpretimin e nenit 77, pika 2 të Kushtetutës, është përcaktuar se parimet kushtetuese, veçanërisht, parimi i ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, i të drejtës për një proces të rregullt ligjor, i prezumimit të pafajësisë, i paanshmërisë, i respektimit të jetës private të individit, përbëjnë standarde kushtetuese mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë komisionet hetimore parlamentare.

54. Në këtë drejtim, qëndrimet që ka mbajtur jurisprudenca kushtetuese shqiptare për domosdoshmërinë e respektimit të parimeve të lartpërmendura dhe koncepteve kushtetuese gjatë kryerjes së hetimeve parlamentare, janë fokusuar drejt argumentit se funksioni kontrollues i Kuvendit nuk mund të qëndrojë jashtë natyrës së tij ligjvënëse. Ushtrimi i funksionit të hetimit parlamentar nuk mund të realizohet duke ndërhyrë në veprimtarinë e organeve të pavarura. Natyra e hetimit parlamentar nuk është e njëlllojtë dhe nuk mund të barazohet me hetimin që realizojnë në bazë të ligjit organet e tjera të pavarura apo të specializuara për kryerjen e një funksioni të tillë. Nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me parimet kushtetuese një hetim i iniciuar që nuk i përket veprimtarisë së legjislativit dhe qëllimeve të tij. Ky instrument i rëndësishëm, nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive dhe tej hapësirës kontrolluese që Kushtetuta i njeh Kuvendit<sup>34</sup>.

55. Për këtë arsye, në të dy kërkesat për ngritjen e Komisioneve Hetimore, por edhe në tekstin e projektvendimit që shoqëron këto kërkesa, është specifikuar shprehimisht se: *“III. Komisioni ka të drejtë të hetojë dhe të bëjë transparencë të plotë për çdo çështje që përfshihet në objektin e punës së tij, në përputhje me parimet kushtetuese, veçanërisht parimin e ndarjes së pushteteve, duke mos iu mbivendosur punës së organeve të drejtësisë, parimin për një proces të rregullt*

<sup>32</sup> Shih vendimet nr.22, datë 05.05.2010; nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>33</sup> Shih vendimet nr.22, datë 05.05.2010; nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>34</sup> Shih vendimin nr.22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese

*ligjor, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e paanshmërisë dhe respektimit të jetës private të individit.”.*

56. Shtuar kësaj, edhe vetë mazhoranca nuk ka paraqitur ndonjë argument se objekti i hetimit të kërkuar cenon parimet kushtetuese, apo shkon përtej rolit kontrollues të Kuvendit të Shqipërisë. Po në këtë aspekt, parimet duhen respektuar gjatë fazave të ndryshme të realizimit të qëllimit të hetimit: në çastin e formulimit të objektit (fakt që provohet se ka ndodhur); gjatë ushtrimit të veprimtarisë së komisionit (projektvendimi e parashikon shprehimisht një detyrim të tillë); dhe në hartimin e konkluzioneve përfundimtare të hetimit.

57. Nga ana tjetër, kërkesa dhe objekti i hetimit parlamentar të kërkuar përmbush të paktën tre kushte kryesore: 1) çështja ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe funksione të tjera për të cilat Kuvendi është i autorizuar të marrë masa ligjore; 2) objekti i hetimit fokusohet në çështje ose në subjekte konkrete; 3) ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme që dëshmojnë për ekzistencën e një çështje, për të cilën është i nevojshëm hetimi. Për pasojë kërkesa dhe objekti i hetimit përmbush të gjitha kushtet kushtetuese<sup>35</sup> për t’u pranuar.

58. Objekti i hetimit, i parashtruar në mënyrë të qartë e të saktë, përmban fakte ose tërësi faktesh, nga të cilët merr shkas hetimi parlamentar dhe shpjegon se çfarë kërkohet të hetohet. Veç kësaj, objekti i hetimit është përcaktuar në mënyrë të mjaftueshme, kusht ky që kërkohet për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës, respektimit të të drejtave themelore, të parimit të ndarjes së pushteteve si dhe të kompetencave të kufizuara që disponon një komision hetimor<sup>36</sup>.

59. Objekt i hetimit parlamentar në të dy Komisionet Hetimore të kërkuara i referohet një çështje që përmbush kriterin e veçantisë. Sic ka përcaktuar edhe Gjykata Kushtetuese, në parim “çështje e veçantë”, objekt i hetimit parlamentar, është një çështje me rëndësi të veçantë shtetërore/publike. Lista e këtyre çështjeve me rëndësi/interes të madh shtetëror/publik nuk mund të jetë shteruese, por duhet të përcaktohet rast pas rasti. Gjykata Kushtetuese është shprehur se “një çështje” që në aspektin kushtetues mund t’i nënshtrohet hetimit parlamentar, përbëhet nga fakte apo rrethana, të cilat përfshihen në objektin e veprimtarisë së Kuvendit dhe për të cilat ekziston një mosmarrëveshje. Në këtë kuptim, çështja është manifestuar përpara marrjes së një vendimi përkatës nga ana e Kuvendit për ngritjen e një komisioni hetimor. Për pasojë, plotësohet kërkesa kushtetuese që komisioni hetimor parlamentar ngrihet kur ekziston në fakt një çështje në kuptimin kushtetues dhe jo për të verifikuar nëse mund të zbulohet ose të gjendet ndonjë e tillë në të ardhmen<sup>37</sup>. Në rastin konkret ekzistojnë të dhëna konkrete që veprimtaria e dy institucioneve publike për të cilat kërkohet hetimi (ARRSH dhe AKSHI) ka cenuar interesin publik, dhe që ka çështja ka ndodhur dhe ekzistojnë fakte dhe të dhëna që justifikojnë hetimin.

60. Qëllimi i ngritjes së Komisionit Hetimor përputhet me kompetencat kushtetuese të Kuvendit, pra me të drejtën e pushtetit legjislativ për t’u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen për zbatimin e ligjeve nga organet e pushtetit publik, në rastin konkret nga ana e administratës shtetërore. Po në këtë aspekt, objekti nuk përmban pasaktësi apo paqartësi të dukshme në mënyrën e formulimit të tij pasi shpjegohen faktet që duhet të hetohen. Është kompetencë e Kuvendit, në

<sup>35</sup> Shih vendimet nr. 20, datë 04.05.2007 dhe nr.18, datë 14.05.2003 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>36</sup> Shih vendimin nr.22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese

<sup>37</sup> Shih vendimin nr.22, datë 05.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese

rastin konkret e pakicës parlamentare, të vlerësojë interesin publik për çështjet që kërkon të hetohen.

61. Në këtë mënyrë, qartësisht ekziston një çështje e veçantë, domethënë një çështje e një rëndësie të veçantë publike, për të cilën Kushtetuta nuk ndalon Kuvendin që, në funksion të veprimtarisë së tij ligjvënëse, të ngrejë komisione hetimi, të tilla që mund të ngarkohen me hetimin e aktivitetit të shtetit, pra për mënyrën si kryejnë institucionet përkatëse shtetërore funksionet e tyre të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligje<sup>38</sup>.

62. Në rastin konkret, me vendimet nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026, Kuvendi nuk ka miratuar kërkesën e deputetëve të pakicës parlamentare për ngritjen e dy Komisioneve Hetimore, me një “arsyetim” që nuk lidhet me objektin e punës së këtyre komisioneve, apo për shkak se ka konstatuar se është në kundërshtim me nenin 77 të Kushtetutës, si dhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

63. Nga materialet e referuara në këtë kërkesë dhe që gjenden edhe bashkëlidhur<sup>39</sup>, konstatohet se mazhoranca nuk ka ngritur asnjë pretendim që provon cënimin nga kërkesat të standardeve kushtetuese. Edhe gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë në seancën plenare të Kuvendit të datës 09.04.2026, vërehet se diskutimi mbi ngritjen e Komisionit Hetimor është reduktuar thjesht në një paraqitje të ndryshme të rrethanave nga përfaqësuesi i pakicës dhe ai i shumicës parlamentare, por pa përmbushur mazhoranca detyrimin e saj: (i) të evidentimit të standardeve kushtetuese që cenohen nga objekti i hetimit; apo (ii) pa formuluar asnjë propozim alternativ. Më pas është kaluar në votimin e kërkesës, ku qartësisht mazhoranca kishte shprehur vullnetin politik për rrëzimin me votë të një të drejte kushtetuese të deputetëve të pakicës parlamentare. Me vendimet nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026, Kuvendi nuk ka miratuar kërkesën e deputetëve të pakicës parlamentare për ngritjen e Komisioneve Hetimore.

64. Evidentohet qartësisht se gjatë debatit parlamentar, diskutimet në Konferencën e Kryetarëve dhe në seancën plenare në Kuvend nuk janë zhvilluar në drejtim të arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet palëve lidhur me objektin e hetimit, deri në marrjen e një vendimi. Kjo për përgjegjësi të plotë të mazhorancës, sepse deputetët e pakicës në mirëbesim, kanë shprehur gadishmërinë që të shqyrtojnë cdo formulim alternativ të objektit të punës së Komisioneve. Shumica parlamentare në rastet kur pretendon se cenohen standardet dhe parimet kushtetuese në objektin e hetimit (gjë që nuk e ka pretenduar në asnjë moment), është e detyruar të propozojë formulime alternative duke i dhënë mundësinë pakicës të riformulojë kërkesën e saj. Këtë detyrim mazhoranca nuk e ka përmbushur, duke provuar se refuzimi i kërkesave ishte vetëm vullnet politik për të refuzuar një të drejtë kushtetuese të deputetëve të opozitës.

65. Gjatë diskutimit parlamentar, arsyetimi i shumicës parlamentare është tepër i përgjithshëm dhe nuk jep shkaqet e vërteta për të cilat është vendosur rrëzimi i kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor. Nga diskutimi për shqyrtimin e kësaj kërkesë në Konferencën e Kryetarëve, në seancën plenare në Kuvend, sikurse u theksua më lart, vërehet se arsyeja e mospranimit të saj nuk lidhet me formulimin e objektit të hetimit parlamentar, por me citime dhe referime të gabuara në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

<sup>38</sup> Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.22, datë 05.05.2010 dhe nr.20, datë 04.05.2007

<sup>39</sup> Pocesverbalet e mbledhjeve të organeve të ndryshme të Kuvendit gjatë procedurës parlamentare të shqyrtimit të këtyre dy kërkesave

66. Për të gjitha sa më lart, është e provuar që debati parlamentar nuk ka pasur si orientim kryesor mbrojtjen e të drejtës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, por mohimin e saj. Për rrjedhojë, vendimet e Kuvendit nr. 57/2026 dhe nr. 58/2026, në këtë aspekt, nuk janë të pajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

#### IV. PËRFUNDIME

67. Bazuar në sa më sipër, lidhur me të drejtën e pakicës parlamentare për të iniciuar një kontroll parlamentar, ritheksojmë se ngritja e komisionit hetimor parlamentar, kur kërkohet nga pakica parlamentare, është e detyrueshme. E drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor nuk mund të vihet në diskutim. Kushtetuta "... ka evituar, veçanërisht për ngritjen e komisionit, kalimin e çështjes në procedurat e zakonshme të votimit" dhe, mbi këtë bazë, Kuvendi "... ka detyrimin që të mos e diskutojë ngritjen e komisionit" kur kjo kërkohet nga pakica parlamentare.

68. Në përmbledhje të të gjitha fakteve dhe argumenteve të parashtruara në këtë kërkesë, bazuar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, vlerësojmë se:

- Është cenuar e drejta e pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor, e cila nuk mund të mohohet apo të kufizohet nëpërmjet vendimmarrjes së shumicës parlamentare. Ajo është një e drejtë kushtetuese që çon detyrimisht në ngritjen e komisionit;
- Në rastin konkret, objekti i hetimit të Komisionit Hetimor është në përputhje me natyrën e këtij komisioni, si dhe me kriteret dhe standardet kushtetuese të analizuara dhe trajtuara nga jurisprudenca kushtetuese;
- Shkaku i lindjes së mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit duhet kërkuar të mohimi, nga ky i fundit (Kuvendi), i kompetencës kushtetuese të pakicës parlamentare për ngritjen e komisionit hetimor me argumentin jokushtetues;
- Mazhoranca nuk ka bërë asnjë përpjekje dhe asnjë formulim alternativ në raport me objektin e hetimit.

#### PËR KËTO ARSYE,

Në mbështetje të neneve 7, 77, 78, dhe 131, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenit 25 i Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; neneve 54, 55 dhe 56 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", të ndryshuar; dhe ligji nr. 8891, datë 02.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit", i ndryshuar,

#### K Ë R K O J M Ë:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Zgjidhja e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, duke përcaktuar detyrimin e Kuvendit për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit: (i) "Për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore"; (ii) "Për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për

- vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend i NATO-s”.
3. Deklarimi i vendimit nr. 57/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor për kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve dhe mosveprimeve të Autoritetit Rrugor Shqiptar për realizimin e investimeve në infrastrukturën rrugore”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
  4. Deklarimi i vendimit nr. 58/2026 të Kuvendit të Shqipërisë “Për mosmiratimin e projektvendimit “Për ngritjen e Komisionit Hetimor për kontrollin e ligjshmërisë në funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për vlerësimin e sigurisë kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave të qytetarëve, si dhe për analizimin e rreziqeve për sigurinë kombëtare dhe detyrimet e Shqipërisë si vend i NATO-s”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**Gjithashtu, në përfundim, për shkak të interesit publik që paraqet kjo çështje, kërkojmë përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.**

E nderuar Znj. Kryetare,

Në përmbajtje të kërkesës për zgjidhjen e konfliktit të kompetencave dhe shfuqizimin e vendimeve nr. 57/2026 dhe 58/2026, kërkuessit kanë arsytuar se vendimmarrja e Kuvendit sjell pasojë që prekin drejtpërdrejtë të drejtën kushtetuese të deputetëve të pakicës parlamentare (*jo më pak se një e katërta e deputetëve*) për ngritjen e komisioneve hetimore parlamentare. Kjo pasi nëpërmjet kësaj vendimmarrjeje, ngritja e komisioneve hetimore të Kuvendit është tërësisht në vullnetin e mazhorancës.

Hetimi parlamentar është jo vetëm një e drejtë e garantuar nga neni 77, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë, e deputetëve të pakicës parlamentare, por edhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit të Shqipërisë që lidhet me ushtrimin e kontrollit efektiv të qeverisjes. Funkcioni kontrollues i Kuvendit është mishërimi në praktikë i parimit të ndarjes së pushteteve (*shih nenin 7 të Kushtetutës*), i cili garanton që Kuvendi të monitorojë dhe kontrollojë mënyrën se si pushteti ekzekutiv vë në zbatim kuadrin ligjor të miratuar nga Parlamenti. Që kontrolli i Kuvendit të jetë efektiv, Kushtetuta dhe Rregullorja i njohin atij një sërë mekanizmesh ligjorë, ku përfshihen seancat e pyetjeve, mocionet e debateve parlamentare, interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore etj. Ndër mjetet më të rëndësishme të kontrollit parlamentar mbi qeverisjen mbetet ngritja e komisioneve hetimore për shqyrtimin e çështjeve të veçanta, nëpërmjet të cilit kontrollohet zbatimi i ligjeve, nxirren përgjegjësitë institucionale, vlerësohet nevojja për rishikimin, ndryshimin apo miratimin e ligjeve, me qëllim parandalimin e fenomeneve negative për shtetin dhe shoqërinë në të ardhmen. Sikurse theksohet në kërkesë, gjatë kësaj Legjislature, shumica ka refuzuar çdo mekanizëm kontrolli të kërkuar nga pakica parlamentare, duke asgjësuar në këtë mënyrë funksionimin demokratik të vetë Kuvendit dhe duke vënë në pikëpyetje nevojën e pjesëmarrjes në Kuvend të deputetëve të pakicës parlamentare, sa kohë mekanizmat e kontrollit që i njeh Kushtetuta refuzohen në mënyrë antikushtetuese me votë të mazhorancës në Kuvend.

Në kushtet kur çështja prek një prej të drejtave themelore që Kushtetuta e Shqipërisë i garanton deputetëve të pakicës parlamentare dhe një prej funksioneve themelore të Kuvendit, atë të kontrollit efektiv të qeverisjes, është e kuptueshme se kjo çështje mbart një interes të veçantë publik, dhe shqyrtimi i saj duhet të bëhet me përparësi, siç ka vepruar Gjykata edhe në precedentin e mëparshëm. Shqyrtimi me përparësi i kësaj çështjeje duhet të marrë në konsideratë edhe faktin se vonesat në realizimin e hetimit parlamentar në dy kërkesat e refuzuara mund të sjellin pasoja në vetë efikasitetin e hetimit.

Po ashtu, Gjykata duhet të konsiderojë faktin se legjislatura parlamentare aktuale është në fillimin e saj, dhe vendosja e një standardi të shpejtë nga ana e Gjykatës Kushtetuese do të ndihmojë në realizimin në kohë të funksionit kontrollues të Kuvendit.





Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, në mbështetje të nenit 11, pika 2, gërma “c”, të Rregullores “Për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, përfundimisht,














### K Ë R K O J M Ë EDHE:














1. Pranimin e kësaj kërkesë procedurale.
2. Shqyrtimin brenda një afati sa më të shpejtë dhe me përparësi të kërkesës së 46 deputetëve për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet jo më pak se një të katërtës së deputetëve dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë: Deklarimin si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 57/2026 të Kuvendit të Shqipërisë dhe Deklarimin si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 58/2026 të Kuvendit të Shqipërisë.














Me konsideratë,



### DEPUTETËT E KUVENDIT TË SHQIPËRISË:

NR.	EMËR MBIEMËR	NËNSHKRIM
1.	<b>GAZMENT BARDHI</b>	
2.	<b>ALBANA VOKSHI</b>	
3.	<b>KLEVIS BALLIU</b>	
4.	<b>AGRON GJEKMARKAJ</b>	

5.	<b>SALI BERISHA</b>	
6.	<b>OERD BYLYKBASHI</b>	
7.	<b>TRITAN SHEHU</b>	
8.	<b>GJIN GJONI</b>	
9.	<b>KASTRIOT PIROLI</b>	
10.	<b>RAMADAN LIKAJ</b>	
11.	<b>BESART XHAFERRI</b>	
12.	<b>ENNO BOZDO</b>	
13.	<b>XHELAL MZIU</b>	
14.	<b>BARDH SPAHIA</b>	
15.	<b>ELDA HOTI</b>	
16.	<b>FLAMUR NOKA</b>	
17.	<b>ZIJA ISMAILI</b>	

18.	<b>LUAN BAÇI</b>	
19.	<b>GRETA BARDELI</b>	
20.	<b>ISUF ÇELAJ</b>	
21.	<b>IVI KASO</b>	
22.	<b>JORIDA TABAKU</b>	
23.	<b>LEDINA ALIOLLI</b>	
24.	<b>ARJAN NDOJA</b>	
25.	<b>TEDI BLUSHI</b>	
26.	<b>EDMOND HAXHINASTO</b>	
27.	<b>EDI PALOKA</b>	
28.	<b>MANJOLA LUKU</b>	
29.	<b>BRUNILDA HAXHIA</b>	
30.	<b>FIDEL KREKA</b>	

31.	<b>ERISA XHIXHO</b>	
32.	<b>ARTAN LUKU</b>	
33.	<b>BLEDI HIMÇI</b>	
34.	<b>DENISA VATA</b>	
35.	<b>BELIND KËLLIÇI</b>	
36.	<b>GENT STRAZIMIRI</b>	
37.	<b>JOZEFINA TOPALLI</b>	
38.	<b>VANGJEL DULE</b>	
39.	<b>INA ZHUPA</b>	
40.	<b>KLODIANA ÇAPJA</b>	
41.	<b>IGLI CARA</b>	
42.	<b>SAIMIR KORRESHI</b>	
43.	<b>LUCIANO BOÇI</b>	

44.	<b>BLEDION NALLBATI</b>	
45.	<b>BUJAR LESKAJ</b>	
46.	<b>KLITI HOTI</b>	

Gjithashtu, Ne deputetët nënshkrues si më sipër **AUTORIZOJMË** për përfaqësimin tonë në këtë çështje:

- Kryetarin e Grupit Parlamentar të PD **z. Gazment Bardhi**, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij,
- Kryetarin e Grupit Parlamentar të PL **z. Tedi Blushi**, ose persona të tjerë të autorizuar prej tij, si dhe;
- Avokat **z. Marash Logu**.

Me adresë njoftimi: “Kryesia e Kuvendit, Grupi Parlamentar i PD, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë”; si dhe email: [marashlogual@gmail.com](mailto:marashlogual@gmail.com).

Tiranë, më \_\_\_/06/2026